

Përkrahja e komunikimit gojor



Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes

Nxitje didaktike

Përkrahja e komunikimit gojor

Basil Schader

Livia Huber, Annina Ruder, Flavio Ruffo

Dragana Dimitrijević dhe Gordana Nikolić

Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes

Nxitje didaktike

Seria «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes» (MGJP; në Zvicër GJKA: Mësimi në Gjuhën dhe Kulturën e Atdheut); Nxitje didaktike 3.

Botuar nga Qendra IPE (International Projects in Education) e Shkollës së Lartë Pedagogjike.



Udhëheqës i projektit: Basil Schader

Autorët: Basil Schader, Livia Huber, Annina Ruder, Flavio Ruffo.

Redaktimi nga ana e MGJP: Dragana Dimitrijević dhe Gordana Nikolić

Mësuesit/et provues/e: Nexhat Maloku, Cyrih (GJKA shqip)
Hüsniye Göktaş, Cyrih (GJKA turqisht)
Dragana Dimitrijević dhe Gordana Nikolic,
Cyrih (GJKA serbisht)
Elisa Aeschmann-Ferreira dhe
Raquel Rocha, (GJKA portugalisht)
Hazir Mehmeti, Vjenë
Rifat Hamiti, Dyseldorf

Ilustrimet, koncepti i përgjithshëm pamor dhe realizimi: Barbara Müller, Erlenbach

Përkthimi: Nexhat Maloku, M.A.

Shtypi: Shtypshkronja Printing Press, Prishtina/Kosova

Seria «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes» u mundësua me përkrahjen e Entit Federal për Kulturë (BAK).



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Eidgenössisches Departement des Innern EDI
Bundesamt für Kultur BAK

Ky projekt u financua pjesërisht me përkrahje të Komisionit Evropian. Përgjegjësinë për përmbajtjen e këtij botimi e bartin vetë hartuesit/et; Komisioni nuk merr përgjegjësinë për përdorimin e mëtejshëm të të dhënave të përmbajtjes.



Lifelong
Learning
Programme

Numri ISBN i botimit
përkatës gjermanisht: ISBN 978-3-280-04120-8

Pasqyra e përmbajtjes

Parafjalë për serinë «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes»

7

Hyrje

- | | | |
|---|---|----|
| 1 | Çfarë mendohet me «të folurit»? | 8 |
| 2 | Përkrahja e të folurit – dhe çfarë do të thotë kjo për MGJP | 8 |
| 3 | Qëllimet dhe struktura e kësaj broshure | 10 |
| 4 | Tri pikat kryesore të mësimin aktual të gojëtarisë | 12 |
| 5 | Shkëmbimi dhe bashkëpunimi me klasat e rregullta | 14 |

I

Pjesa I: Ushtrimi i tingujve; nxitje për përdorim krijues gjuhësor

- | | | |
|---|--|----|
| 1 | Ushtrimet akustike, pesë ushtrime për diferencim të tingujve | 16 |
| 2 | «Alma thotë ...» | 18 |
| 3 | «Unë shoh diçka, që ti nuk e sheh» | 19 |
| 4 | «Gjeje dikë, i cili ...» | 20 |
| 5 | «Vendi i nxehtë» | 21 |
| 6 | Vargje për fëmijë dhe rima; vjersha dhe poezi | 22 |
| 7 | Vargje të shqiptuara shpejt, lojëra gjuhësore | 23 |
| 8 | Lojëra rolesh të thjeshta | 24 |

II

Pjesa II: Të sjellurit në mënyrë të përshtatshme në biseda – në çift dhe në grupe

- | | | |
|----|---|----|
| 9 | Të merremi vesh për rregullat e bisedave dhe t'i ushtrojmë ato | 28 |
| 10 | Të përgatitemi për një bisedë | 30 |
| 11 | «Think – Pair – Share»: Një procedurë alternative për t'u përgatitur për një bisedë në grup | 31 |
| 12 | Të lidhemi me ndihmesat në bisedën e të tjerëve | 32 |

13	Të japësh Feedback	33
14	Rolet bisedimore të merren përsipër	34
15	Udhëheqja e bisedës të merret përsipër	35
16	Planifikimi i bisedës	36
17	Të treguarit në rreth	37
18	Bashkërisht të diskutohet dhe të argumentohet	38
19	Udhëheqja e bisedave mësimore	39
20	Bashkërisht të filozofojmë	40
21	Të përgatitet një pyetësor ose një intervistë	41

III

Pjesa III: Të treguarit dhe të luajturit e përjetimeve dhe të tregimeve

22	Të treguarit të përgatitet dhe të ushtrohet	46
23	Tregime përditshmërie	48
24	Tregimet personale	49
25	Tregimet e modeluara	50
26	Lojëra pothuajse reale, lojëra rolesh sociale	51
27	Lojëra fiktive, dramatizimi i teksteve	52
28	Lojë teatrore shkollore	53

IV

Pjesa IV: Të prezantuarit dhe të referuarit

29	Të ushtrohet leximi para të tjerëve	56
30	Të përgatitet referimi dhe recitimi	58
31	Të mbahet një referat: shembull «Referat i shkurtër për një temë faktike»	60
32	Për vlerësim: dritë blici	61
	Literatura e përdorur	62

Sqarimet, shkurtesat

Gjuha e parë:	Edhe gjuhë amtare – ose familjare: gjuha të cilën një fëmijë e ka mësuar dhe folur si gjuhë të parë në shtëpi. Mjaft fëmijë kanë dy gjuhë.
Gjuha shkollore:	Gjuha e cila flitet në shkollën e vendit emigrues. Gjithashtu mund të vijë edhe dialekti lokal si gjuhë e rrethit
Shkurtesat:	N = Nxënës, nxënëse M = Mësues, mësuese

Legjenda

për të dhënat për formën sociale, klasën dhe kohën e nevojshme tek
propozimet mësimore:



PI = Punë individuale



PP = Punë me partner



GV = Grup i vogël



TK = Tërë klasa

KP–kl. 9

E përshtatshme për klasat ... deri ... (p.sh. kl
2–4). Kujdes: Kjo renditje mund të ndryshojë
sipas parakushtit të nxënësit,-es veç e veç.
(KP = Kopshti Parashkollor)

10–15 min.

Nevoja për kohë të përafërt, p.sh. 20 min.
(e dhënë e përafërt, duhet të vendoset nga
mësimdhënësi sipas gjendjes së parakushteve
të klasës).

Parathënie për serinë «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes»

Mësimi në gjuhën amtare ose të prejardhjes (MGJP; në Zvicër GJKA, mësimi në gjuhën dhe kulturën e atdheut) luan një rol të rëndësishëm për zhvillimin gjuhësor dhe të identitetit si dhe për përkujdesjen për shumëgjuhësinë, si një rekurs vetjak dhe shoqëror me shumë vlerë. Lidhur me këtë fakt, hulumtimet, linjat drejtuese, si edhe rekomandimet e Këshillit të Evropës R(82) 18 dhe R (98) 6, janë të qarta që prej shumë kohësh. Megjithatë ky mësim zhvillohet, në krahasim me mësimin e rregullt, ende në kushte të vështira. Kjo gjë ndodh për arsye të ndryshme:

- Mësimi në gjuhën e prejardhjes në shumë vende, përsa i përket aspektit financiar dhe institucional, qëndron në themele të dobëta. Pagesa e mësimdhënësve në Zvicër është pothuaj si kudo çështje e vendeve të prejardhjes madje edhe e prindërve.
- Mësimi në gjuhën e prejardhjes është më së shumti i lidhur jo mirë me mësimin e rregullt. Kontaktet dhe bashkëpunimi me mësimdhënësit e klasave të rregullta, shpesh zhvillohen shumë dobët.
- Mësimi në gjuhën e prejardhjes zhvillohet në më të shumtën vetëm dy orë në javë, gjë që e vështirëson punën në vazhdimësi.
- Mësimi në gjuhën e prejardhjes është, në të shumtën, vullnetarisht, detyrimi për nxënësit nuk është shumë i fortë.
- Mësimi në gjuhën e prejardhjes, si rregull, zhvillohet si mësim në shumë klasa, në të cilin marrin pjesë njëkohësisht nxënës që nga klasa e parë e deri në klasën e nëntë. Kjo kërkon nga mësimdhënësit aftësi të lartë didaktike si edhe aftësi për të diferencuar nxënësit në klasë.
- Heterogjeniteti i bashkësisë së nxënësve në mësimin e gjuhës së prejardhjes është veçanërisht shumë i lartë edhe në raport me kompetencat gjuhësore të nxënësve, ndërkohë kur disa sjellin nga shtëpia njohuri të mira në variantet dialektore ose të standardit të gjuhës së parë, të tjerë e flasin këtë vetëm në dialekt. Shumica që jeton tashmë në gjeneratën e dytë apo të tretë në vendin e ri të emigrimit, gjuha e atij vendi (p.sh. gjermanishtja) është bërë gjuhë e fortë, derisa gjuhën e parë e zotërojnë vetëm në variantin dialektor, dhe atë vetëm gojariht dhe me një leksik të kufizuar rreth temave familjare.

- Mësuesit e gjuhës së prejardhjes parimisht kanë marrë në vendet e tyre të prejardhjes një arsimim të mirë bazë, por nuk janë të përgatitur për realitetin dhe specifikat e mësimin në shkollat me shumë klasa në emigrim. Mundësitë e kualifikimit në vendet e emigrimit zhvillohen në masë ende të pamjaftueshme.

Seria «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes» i përkrah mësimdhënësit e këtij mësimi në detyrën e tyre të rëndësishme e me kërkesa të larta, e me këtë dëshiron të japë ndihmesë për një cilësi maksimale të tij. Nga njëra anë është me rëndësi dhënia e principeve dhe e arsyeve të pedagogjisë dhe didaktikës në vendet emigruese perëndimore dhe evropianoveriore, (krahaso fletoren «Bazat dhe sfondet») nga ana tjetër dhënia e shtysave dhe modeleve mësimore praktike e konkrete. Përparësi përbën këtu përkrahja e kompetencave gjuhësore. Tek shtysat didaktike në mënyrë të vetëdijshme përdoren principet dhe metodat, të cilat për nxënësit janë të njohura nga mësimi i rregullt dhe tekstet mësimore përkatëse. Për këtë do të duhej që mësimi në gjuhën e prejardhjes dhe mësimi i rregullt, mundësisht t'i afrohen njëri-tjetrit në kuptim të një koherence të madhe. Përmes faktit që mësimdhënësit e mësimin në gjuhën e prejardhjes, njohin edhe elemente didaktike dhe metoda konkrete, që janë aktuale tek nxënësit në mësimin e rregullt, ata bëjnë njëkohësisht një pjesë kualifikimi dhe shpresojmë për një forcim të formimit të tyre si partnerë të barasvlershëm në procesin arsimor me nxënësit e rritur në sfondin dygjuhësor respektivisht dykulturor.

Seria «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes» botohet nga Qendra «International Projects in Education (IPE)» dhe Shkolla e Lartë Pedagogjike Cyrih. Ajo lindi mes një bashkëpunimi të ngushtë ndërmjet personave profesionistë zviceranë, atyre evropianoperëndimor në njërin anë, dhe të ekspertëve e mësimdhënësve të mësimin në gjuhën e prejardhjes, nga ana tjetër. Me këtë do të sigurohet se dhënia e informacioneve dhe e shtysave u përgjigjet gjendjes faktike, nevojave dhe mundësive të mësimin në gjuhën e prejardhjes dhe se janë funksionale e praktike për këtë mësim.

1. Çfarë mendohet me «të folurit»?

Përveç të shkruarit, të folurit është fusha e dytë e madhe e përdorimit të gjuhës. (Në fakt, edhe e para: si në historinë e njerëzimit, ashtu edhe në atë të pothuajse të gjithë individëve, teknikat e kulturës së të shkruarit dhe të lexuarit paraqiten vetëm pas një periudhe të gjatë të komunikimit thjesht me gojë.)

Gojëtaria i përfshin të dy aspektet e të dëgjuarit dhe të folurit. Me këtë adresohen fusha përvetësuese (të dëgjuarit / të kuptuarit e së dëgjuarës), dhe fusha prodhuese (të folurit) në komunikimin gojor. Në veçanti, me këtë edhe është sinjalizuar se përkrahja e të dëgjuarit luan rol të barabartë dhe të rëndësishëm, kur bëhet fjalë për zhvillimin e kompetencave komunikuese.

Puna në fushën e të folurit duhet të zbatojë rregullat e veta, por nuk rrjedh veçmas nga përkrahja e të shkruarit. Përkundrazi, të dyja këto fusha të mëdha gjenden me njëra-tjetrën në një marrëdhënie që mund të përshkruhet si qarkuese: Ajo që është ushtruar në fushën e të shprehurit me gojë, i hyn në shërbim pastaj të të shkruarit dhe, anasjelltas, të shkruarit e zhvilluar ndikon në diferencimin e të shprehurit me gojë.

Tek karakteristikat e veçanta të përdorimit të gjuhës së folur përfshihen pikat e mëposhtme, të cilat janë me rëndësi edhe për punën në shkollë:

- Në situatat e komunikimit me gojë, bashkëbiseduesit /et gjenden zakonisht në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend. Me këtë është i mundur përdorimi i mjeteve mimike, i gjeesteve dhe shenjave joverbale, të situatës (p.sh., të dhëna për një person në afërsi ose për qiellin me re). Këto mjete ndihmojnë për të mbështetur mirëkuptimin, i cili është i arsyeshëm dhe funksional kundrejt «shpejtësisë» së komunikimit gojor. Në situatat e të shkruarit, në të cilat hapat «të shkruarit» dhe «të lexuarit» zhvillohen në kohë të ndryshme dhe që, nëpërmjet përpunimit dhe rileximit, mund edhe të përsëriten, kjo është krejt ndryshe. (Një pozitë të veçantë, në të cilën ne nuk do të hyjmë këtu, marrin bisedat telefonike apo shkëmbimet me shkrim.)

- Në aspektin gjuhësor, të folurit i ndjek rregullat e veta, të cilat ndryshojnë nga ato të gjuhës së shkruar. Kështu fjalitë e paplota, ndërprerjet e fjalive, përsëritjet, ndryshimi përzgjedhës gjuhësor (për shembull, nga gjuha e parë në gjuhën e shkollës ose nga gjuha standarde në dialekt), kërcime asociuese etj., janë normale dhe nuk pengojnë në bisedat e përditshme ose vetëm në raste të jashtëzakonshme. Në rastin e të folurit «të kulturuar», si për shembull në një referat në shkollë, vlejnë normat e rrepta të drejtuara më shumë në të shkruarit. Por, edhe këtu, patjetër do të ishte gabim të kërkohet nga nxënësit/et që ata të flasin pothuajse «si libër.» Megjithatë, kjo nuk do të thotë që duhet të heqim dorë nga situatat e trajnimit, në të cilat ushtrohet qëllimisht një stil i pastër me gojë dhe i cili duhet të praktikohet në kontekste motivuese (prezantim skenik, referat etj.).

2. Përkrahja e të folurit – dhe çfarë do të thotë kjo për MGJP

Të folurit luan rol të rëndësishëm në mësimin e gjuhës; kjo vlen gjithashtu edhe për mësimin në gjuhën e pre-jardhjes. Rëndësia e këtij roli është e dukshme tashmë në faktin se (sidomos në klasat e ulëta), shumica e komunikimit në klasë bëhet gojorisht. Kushdo që dëshiron të marrë pjesë në jetën e shkollës, duhet, në njërin anë, të dëgjojë dhe të dëgjuarit të mund ta kuptojë, porse, në anën tjetër, ai duhet të ketë aftësi të ndryshme prodhuese në fushën e gojëtarisë. Pozicionin e lartë të të folurit e tregon gjithashtu kjo pasqyrë e përgjithshme e shkathtësive gjuhësore dhe e fushave të mbështetjes:

	Aftësitë perceptuese	Aftësitë produktive
Të folurit: shkathtësitë parësore, «të lindura»	Të dëgjuarit (të kuptuarit e të dëgjuarit)	Të folurit
Të shkruarit: teknikat kulturore dytësore të mësuara	Të lexuarit (Të kuptuarit e të lexuarit)	Të shkruarit

Për të mbështetur të dy fushat e mëdha, të folurit dhe të shkruarit, do të duhej të përmendet edhe përvetësimi i leksikut dhe i gramatikës, i cili ndodh në «mënyrë natyrore» dhe të pakontrolluar, e nga ana tjetër duhet të mbështetet dhe të zgjerohet në shkollë.

Formimi i kulturës së teknikave në të shkruar dhe në të lexuar kërkon, në shumicën e rasteve, aftësi të zhvilluara të gojëtarisë, në fushat e të dëgjuarit dhe të të folurit. Shumica e fëmijëve, në fillim të shkollimit, sjell në këtë drejtim aftësi të mira, të paktën për sa i përket mënyrës së të folurit të përditshëm. Megjithatë, fakti se mësimi i gjuhës në shkollë ka një gamë të tërë të detyrave të zhvillimit në fushën e të folurit është i dukshëm. Me këto përparësi të këtij drejtimi (didaktika e të folurit, të treguarit, prezantimi etj) merret kreu 4a «Qëllimet dhe fushat e punës në lëmin e të folurit». Këto përparësi janë, gjithashtu, të rëndësishme edhe për MGJP dhe formojnë bazën e klasifikimit të propozimeve mësimore në pjesën praktike të kësaj fletoreje.

Veç kësaj, ka edhe disa veçori të përkrahjes së të shprehurit me gojë në MGJP në fushën e fonetikës, leksikut dhe sintaksës, me të cilat ne do të merremi në mënyrë posaçme që më parë. Shkaku i saj është ndodhja pranë e pranë e dialekteve dhe gjuhës standarde në shumë gjuhë dhe fakti se shumë nxënës/e gjuhën e tyre të parë nga shtëpia prindërore e njohin pothuajse vetëm në një variant dialektor. Për MGJP, ku pjesë e qëllimeve të tij është mësimi i gjuhës standarde, dalin këto detyra dhe fusha pune, si vijon:

a) Hyrje e kujdesshme në inventarin e fonemave të gjuhës së parë

Këtu përfshihet vetëdija e qartë dhe trajnimi akustik sidomos për ata tinguj të gjuhës standarde, të cilët eventualisht ndoshta janë të panjohur nga dialekti ose nuk dallohen. Një shembull: Në gjuhët e sllavëve të jugut, tingujt (gjegjësisht fonemat) <tsch> dhe <tch> (si në <Hütchen>) dallohen; për të parën qëndron <č>, për tch <č>. Në shqip i njëjti dallim është me grafemën <ç> dhe <q>. Në disa dialekte ky dallim (i cili është i vështirë për të huajt), bëhet pak ose fare. Kjo do të thotë se këtu janë të nevojshme ushtrimet e veçanta në të dëgjuarit dhe të folurit. Qëllimi është për të stërvitur veshin e fëmijëve, pasi këto dallime janë me të vërtetë të rëndësishme edhe për drejtshkrimin. Pa këto ushtrime përkatëse nxënësit do të bënin në tekstet e tyre gjithnjë gabime, të cilat rezultojnë nga mungesa e këtij dallimi. (Një shembull nga mësimi gjermanisht janë mënyrat e të shkruarit të fëmijët si «Kese» und «Medchen» në vend të «Käse» und «Mädchen», të cilët dallimin mes <ä> dhe <e> të gjatë nuk e kanë kuptuar.) Ushtrimet akustike të dallimit (të cilat fëmijët tashmë i dinë nga mësimi i rregullt) mund të kryhen lehtë; shih. sugjerimet në nr. 1 në pjesën praktike. Një kontekst veçanërisht të përshtatshëm për këtë ofron mësimi i shkronjave përkatëse në klasën e parë apo të dytë.

b) Puna në leksik

Një fushë gjuhësore për fonemat dhe grafemat qëndron te fjalët. Përsëri, mund të ketë dallime të shumta mes versionit standard dhe dialekteve të gjuhës së parë, por edhe mes dialekteve të ndryshme.

Këto duhet të diskutohen dhe, nëse është e mundur, edhe paraqiten në një hartë; këtu qëndrojnë mundësi të vlefshme për njohje dhe reflektim të gjuhës amtare në të gjitha aspektet e saj. Përveç kësaj, natyrisht, duhet të mësohen gradualisht dhe të ushtrohen me kujdes nocionet e gjuhës standarde. Ndoshta nxënësit/et marrin për këtë një fletore të vogël, në të cilën ata shkruajnë fjalët dhe frazat, formojnë dhe fjali, së pari me gojë, pastaj eventualisht edhe me shkrim. Puna në leksik, për të cilën bëhet fjalë këtu, paraqet një fushë të rëndësishme të përkrahjes gjuhësore në MGJP dhe për këtë duhet të ketë një përkujdesje shumë të ndërgjegjshme. Arsyeja është e qartë: shumë fëmijë dhe të rinj, që rriten në migrim, e zotërojnë gjuhën e tyre të parë në mënyrë të kufizuar, d.m.th., të kufizuar në fjalorin e përditshëm familjar, me përdorimin gojor dhe në dialekt. Që shumë prej tyre ndihen më të fortë në gjuhën e shkollës të vendit pritës, nuk është çudi, ngase ata përkrahen çdo ditë dhe në mënyrë sistematike në këtë. MGJP përbën një institucion qendror (dhe, për fëmijët nga familjet më pak të arsimuara, pothuaj të vetmin), kur është fjala për qëllimin e rëndësishëm për ta vënë edhe gjuhën e parë në shfrytëzim të përdorimit me kërkesa të larta. Të shprehurit me gojë – të kuptuarit e asaj që dëgjohehet dhe të folurit personal – luan një rol, rëndësia e të cilit nuk mund të nënvlerësohet. Kjo lejon takime dhe eksperimente me aspektet e reja të përdorimit të gjuhës, të cilat të shumtën e herës janë të thjeshta dhe më të kapshme, sesa ato të fushës së shkruar. Marrëveshjet mësimore të pasqyruara dhe të planifikuara mirë në fushën e të folurit edhe këtu janë me vlerë të lartë, kur bëhet fjalë për qëllimin e përvetësimit të aftësive të mira në gjuhën e parë.

c) Mjetet e zgjeruara të të folurit dhe sintaksa

Puna në leksik, e cila është e kufizuar vetëm në fjalë, arrin pak. Tashmë janë përmendur shprehjet frazeologjike, të cilat gjithashtu përfshihen vetkuptueshëm në fjalorin e çdo gjuhe. Ato gjithashtu duhet të bëhen të qarta, të mbahen mend dhe të ushtrohen shumë herë dhe të zbatohen, në mënyrë që të kalojnë në shfrytëzim aktiv të nxënësve/eve. Si mbështetje metodike kuptimplote është dëshmuar shpesh që kjo, së pari, të bëhet gojarisht dhe, më pas, me shkrim. E njëjta gjë vlen edhe për të dy llojet e mëposhtme të grupeve të fjalëve, gjegjësisht mjeteve të të folurit:

1. I ashtuquajtur «chunks» që do të thotë shprehje ose fraza të tilla si «Unë do të doja ...», «A mund t'ju lutem ...», «A mund të më ... ju lutem» etj., «chunks» janë me vlerë të lartë praktike në situata të komunikimit të lehtë formal të përditshmërisë. Që fëmijët t'i dinë mirë këto edhe në variantin standard të gjuhës së tyre të parë, është një nga parakushtet për zotërimin e tyre. Për ushtrime janë të përshtatshme situatat në formë të lojës si p.sh. luajtja e roleve.

2. Si mjet i të shprehurit me përdorim veçanërisht të lartë duhet të jenë në shfrytëzim edhe një mori shprehjesh frazeologjike, të cilat do të përdoren vazhdimisht tek situatat e diskutimeve, në prezantimet e shkurtra etj. Mbështetur në fushën e «diskutimeve» këtu përfshihen shprehje, gjegjësisht pjesë të fjalive të tilla, si: «Sipas mendimit tim, kjo është kështu që ...», «Këtu unë kam mendim tjetër», «Unë pajtohem plotësisht / nuk pajtohem aspak», «Kjo është në thelb e vërtetë, por ...» etj. Mjete të tilla të të folurit duhet, së pari, të përmbliken bashkë me nxënësit/et. Këtu, mbështetja në gjuhën e shkollës mund të jetë shumë e dobishme për shkak se nga kjo fushë janë sigurisht tashmë të njohura shumë gjëra. Më pas, këto mjete të të folurit duhet të regjistrohen në formë të shkruar dhe të ushtrohen gjerësisht. Në doracakun «Bazat dhe arsyet» mund të gjenden në Kap. 7 B4 fotografi nga MGJP spanjisht në Londër, të cilat tregojnë vizualizimin e mjeteve të thjeshta të të folurit, të cilat japin ndihmesë të çmuar në zgjerimin e aftësive në gjuhën e parë. Në pjesën praktike, nr. 12, tregon se si mund të përkrahen nxënësit/et, duke ua dhënë atyre pjesët e ndërtimit të fjalive, se si gjatë bisedës duhet t'i referohen njëri-tjetrit në mënyrë që të forcojnë koherencën e diskutimit.

Me etapën e ardhshme më të lartë të gjuhës – gramatikën me fushat e saj të pjesshme morfologjinë dhe sintaksën, gërshetohen kërkesa të ndryshme, sipas gjuhës amtare dhe varësisht nga dallimet e dialektit dhe të gjuhës standarde. Nxënësit/et kosovarë, ndër të tjera, këtu kanë për të mësuar formën e veçantë të paskajores në gjuhën standarde shqipe, sllavët e jugut duhet të mësojnë përdorimin e drejtë të rasave në versionin standard etj. Si vijë orientuese gjithëpërfshirëse në aspektin e psikologjisë së të mësuarit e vlen që nxënësit/et, atë që duhet ta mësojnë, së pari, ta kuptojnë (më së miri: të bëhet e qartë nëpërmjet të mësuarit zbulues) dhe duhet ta ushtrojnë e zbatojnë në shumë forma e faza të shumta. Këtu të folurit luan rol të rëndësishëm, jo vetëm kur bëhet fjalë për njohjen dhe emërtimin, por edhe për format dialoguese e të ushtrimeve praktike.

d) Lidhja mes gjuhës së parë dhe të dytë

Nxënësit/et e MGJP e njohin jo vetëm gjuhën e tyre të parë, por edhe gjuhën e shkollës së vendit në të cilin ata jetojnë. Ata shpesh ndihen në këtë gjuhë edhe më kompetentë, gjë që nuk është befasi, duke pasur parasysh përkrahjen e përditshme shkollore, ashtu siç u theksua tashmë më lart. Tek përkrahja në gjuhën e parë, në të cilën bëhet fjalë në MGJP, duhet domosdoshmërisht që të shfrytëzohen burimet dhe aftësitë, të cilat shumë nxënës/e i kanë në zotërim nga gjuha shkollore. Këtu përfshihet, për shembull, leksiku, i cili është shpesh më i gjerë sesa leksiku i kufizuar brenda temave shtëpiake e familjare në gjuhën e tyre të parë. Kjo do të thotë që, gjatë punës në leksik, në gjuhën e parë, shpesh mund të drejtoheni tek gjuha shkollore, ku shumica e nocioneve janë të pranishme dhe të sqaruara. Atëherë shpjegimet e gjata në gjuhën e parë janë të panevojshme; fjala është vetëm për të marrë nocionin përkatës dhe për ta transferuar dhe zbatuar. Kjo i takon veçanërisht leksikut përkatës shkollor me kërkesa të larta, i cili është thelbësor për zotërimin e mirë të gjuhës. Por, edhe për mjetet shprehëse të të folurit, të theksuara më lart, mund të mbështetemi shpesh në gjuhën e shkollës. Nëpërmjet këtyre lidhjeve mund të jetë një përparësi e madhe edhe shmangia e rasteve të shpërbërjes shumë problematike të leksikut në gjuhën e parë dhe atë të shkollës, siç është vërejtur shpesh (zakonisht në atë mënyrë që fëmijët e zotërojnë leksikun familjar e shtëpiak në gjuhën e parë dhe leksikun me kërkesa të larta në gjuhën e shkollës). Në një kuptim më të gjerë, këto burime dhe paranjohuri nga mësimi i rregullt, mund dhe duhet të shfrytëzohen edhe tek vështrimi i fenomeneve gramatikore ose tek dhënia e strategjive të të mësuarit (krahaso këtu fletoren 5 të kësaj serie). Në të gjitha këto raste, të folurit si mjet i bisedimeve dhe ushtrimeve, luan gjithashtu një rol të rëndësishëm edhe atëherë kur qëllimi përfundimtar është rritja e aftësitësive letrare. Është e qartë se ky mjet mund të përdoret mirë vetëm atëherë, kur përvetësimi dhe zgjerimi të shkathtësive në të shprehurit me gojë i është kushtuar kohë dhe vëmendje e mjaftueshme.

3. Qëllimet dhe struktura e kësaj broshure

Kjo fletore është e lidhur ngushtë me broshurat didaktike 1 dhe 2 të serisë «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes». Ndërsa fletoret 1 dhe 2 japin nxitje për përkrahjen e të shkruarit gjegjësisht të lexuarit në gjuhën e parë, në fletoren 3 bëhet fjalë për fushën e gjerë të të folurit. Kjo përfshin, siç tregon tabela më lart, dy aspekte të pjesshme të dëgjuarit/të kuptuarit e të dëgjuarit dhe të folurit. Ndryshe nga të lexuarit dhe të shkruarit, këtu nuk bëhet fjalë për

teknikat e kulturës, të cilat do të ndërmjetësohen rrënjësisht nga shkolla, por për zhvillimin e shkathtësive të përditshmërisë, të cilat i sjellin pothuajse të gjithë fëmijët që në kopshtin e fëmijëve. Detyra e shkollës është t'i zhvillojë këto aftësi deri në atë shkallë, sa ato të jenë në dispozicion dhe në funksion të konteksteve gjithnjë e më të stërholluara. Në MGJP kjo ndodh me përqendrim në gjuhën e parë, dhe në veçanti në variantin e tyre standard. Më sipër, në kreun 1d, është treguar se si mund të krijohen lidhje produktive me gjuhën e shkollës.


Propozimet mësimore dhe nxitjet didaktike me të cilat mësuesit/et e MGJP do të mbështeten më pas në punën e tyre të rëndësishme përkrahëse në fushën e të folurit, janë ndarë në fushat e mëposhtme (ku të dëgjuarit vetëkuptueshëm është menduar gjithnjë):

- Ushtimi akustik; nxitje për përdorimin krijues të gjuhës
- Sjellja në mënyrë të përshtatshme në diskutime – në çifte dhe në grupe
- Të treguarit dhe të luajturit e përjetimeve dhe tregimeve
- Prezantimi dhe referimi

Hapësirë veçanërisht të gjerë merr pjesa II me 13 propozimet mësimore («Sjellja në mënyrë të përshtatshme në diskutime – në çifte dhe në grupe»). Kjo nuk është rastësi: Aftësitë dhe kompetencat që do të diskutohen këtu, paraqesin praktikisht themelin e tërë komunikimit dhe kërkojnë ushtrim veçanërisht të kujdesshëm.

Të 32 planifikimet mësimore janë të strukturuar ashtu që në qendër është një prezantim i qartë dhe i kuptueshëm i rrjedhës së propozuar. Këto paraprihen pjesërisht nga shënime që plotësojnë formulimin e qëllimeve dhe japin sfonde të tjera. Rubrikat «Variantet» dhe «Vërejtjet» në fund të disa propozimeve mësimore përfshijnë alternativa metodologjike, si dhe referencat për aspektet e imta didaktike-metodike.

Për aspektet e ndryshme, gjenden udhëzime dhe ushtrime në fletoret e tjera të serisë «Nxitje didaktike»; duke pasur parasysh rëndësinë e të folurit edhe për temat e lidhura me të shkruarit, kjo nuk është e habitshme. Ne u referohemi në veçanti fletoreve dhe krerëve në vijim:



Fletorja 1

Përkrahja e të shkruarit në gjuhën e parë:

krahaso në pjesën praktike, ndër të tjera tek udhëzimi për ushtrimet paraprake në të folur etj. në krerët 1, 2, 7.4, 14, 18 etj.



Fletorja 2

Përkrahja e të lexuarit në gjuhën e parë:

krahaso veçanërisht krerët për leximin paraprak në krerët që lidhen me 1, 10, 11 dhe 16 në pjesën praktike.



Fletorja 4

Përkrahja e kompetencës ndërkulturore:

Shumica e propozimeve mësimore përfshijnë pjesë të rëndësishme në të folur (diskutimet sqaruese, diskutimet për tema faktike etj.).



Fletorja 5

Strategji dhe teknika të të mësuarit:

Këtu pjesët e të shprehurit me gojë lidhen në mënyrë të veçantë me shkëmbimin mbi përvojat me strategjitë e ndryshme të mësimi.

Në përfundim përmendet një tipar, i cili e dallon këtë fletore në krahasim me fletoret e tjera të kësaj serie: si autorë/e kanë punuar këtu më së shumti tre autorë/e të rinj (Livia Huber, Annina Ruder, Flavio Ruffo), të cilët punën e tyre të bachelorit me përkushtim të madh dhe shumë energji ia kanë kushtuar temës «Përkrahja e të folurit në MGJP». Së bashku me udhëheqësin e projektit dhe redaktorët përgjegjës nga ana e MGJP (Dragana Dimitrijeviq dhe Gordana Nikolic) rezultoi në këtë mënyrë një ekip, i cili në përbërjen e tij ishte gjithashtu inovativ dhe produktiv për sa i përket mënyrës së punës.

Si burime të rëndësishme (në mesin e shumë të tjerave) u përfshinë edhe tekstet mësimore «Sprachfenster», «Sprachland», «Sprachwelt Deutsch» «Die Sprachstarken» dhe «Pipapo». Referenca me këto tekste mësimore garanton aktualitetin gjuhësor didaktik dhe mbështet lidhjen e MGJP dhe mësimi të rregullt.

4. Tri pikat kryesore të mësimit aktual të gojëtarisë

Fusha e gojëtarisë është një fushë e gjerë me një literaturë të gjerë në gjuhët dhe traditat e ndryshme. Traditat e ndryshme pasqyrohen, për shembull, në statusin e ndryshëm të qëllimeve në fushat e tilla si «Diskutimi demokratik në këshillin e klasës» ose «Recitimi shprehës i poezisë», që kulturat e ndryshme i kanë pasur e i kanë. Ne po kufizohemi, më poshtë, në disa pika në të cilat didaktika e të folurit në vendet perëndimore dhe veriore evropiane të emigrimit do të duhej të kenë një marrëveshje e të cilat janë me interes edhe për MGJP.

a) Qëllimet dhe fushat e punës në lëmin e të folurit

Qëllimi gjithëpërfshirës i përkrahjes shkollore në fushat e të dëgjuarit dhe të folurit është forcimi i kompetencës vepruese komunikative të nxënësve/eve. Kjo ndodh, si në mësimin e rregullt, ashtu edhe në MGJP sipas moshës së nxënësve dhe në përputhje me objektivin shtesë për t'i udhëhequr nxënësit/et në zotërimin gjithnjë e më të mirë të gjuhës standarde.

Tek produktet gjuhësore të të folurit, d.m.th., gjatë të folurit, dallohen format e dialogut dhe monologut, secila me objektiva të veçanta dhe me mënyrat e punës. Tek format dialoguese lidhet i tërë edukimi në të folur. Qëllimi i tij është sjellja e përshtatshme në dialog, diskutimet në konflikte, luajtja e roleve sociale, intervistat, bisedat (të luajtura) telefonike etj, si dhe sjellja demokratike në të folur dhe në të dëgjuar, e udhëhequr nga rregullat e diskutimit, në bisedat në grup, diskutimet në klasë, debatet për të zgjidhur një konflikt etj. Tek format monologuese numërohet të treguarit, të ligjëruarit dhe prezantimi në kontekste të ndryshme (ku në qendër qëndron dhënia e një përmbajtjeje tërheqëse e të qartë), por edhe të recituarit, të lexuarit e qartë e të modeluar para të tjerëve, si dhe disa forma të teatrit të shkollës, tek të cilat bëhet fjalë (gjithashtu) për një gjuhë shprehëse.

Aspekti «të dëgjuarit» parimisht ushtrohet në lidhje me të folurit dhe qëllimet e vëna aty. Por ai duhet të mbështetet patjetër nga detyra përkatëse, me qëllime të qarta, edhe në rastet kur ato kanë të bëjnë me përmbledhjen e përmbajtjes, të sjelljes demokratike në diskutim, ose të cilësisë së një recitimi. Të dëgjuarit e thjeshtë, pa një detyrë dhe synim të qartë, vlen pak. Aspekt i rëndësishëm është «të dëgjuarit e diferencuar» edhe për ato situata të të mësuarit, në të cilat bëhet fjalë për vëzhgimin e veçorive gjuhësore, p.sh. për identifikimin e varianteve dialektore në gjuhën e parë (mbështetur në provat e të dëgjuarit), ose për të rritur ndërgjegjësimin për veçoritë e caktuara në gjuhën e të folurit të një personi apo grupi. Aftësisë në të dëgjuar i shërben këtu fusha e rëndësishme dhe interesante e pasqyrimin gjuhësor.

Përveç këtyre formave, tek të cilat, para së gjithash, bëhet fjalë për ushtrimet e komunikimit dhe situatave të nxënies, kemi edhe llojin e situatave të lidhura me ushtrimin e shkathtësive. Këtu nuk është një përmbajtje faktike në qendër, por një aspekt gjuhësor. Në këtë kategori përfshihen ushtrimet e lartpërmendura të diferencimit të fonemave të ngjashme (që përfshijnë (p.sh. q / ç, shih më lart kap. 2a) dhe ushtrimet e tjera të të dëgjuarit dhe të shqiptuarit, sidomos në klasat e ulëta. Ushtrimi përkatës nuk mund të bëhet nëpërmjet të folurit të drejtuar riprodhues ose, pak më të lirë (tek të folurit riprodhues futet një model i të folurit të përsëritur pa u ndier, tek të folurit e drejtuar varion një tekst i dhënë paraprakisht; krahaso këtu të ashtuquajturin Scaffolding, i cili është përshkruar në Fletoren 1[Përkrahja e të shkruarit] në kreun 4d të Hyrjes si dhe në doracakun «Bazat dhe arsyet» në kreun 8 A.5a). Në një kuptim më të gjerë, këtu numërohet edhe puna në leksik dhe dhënia e mjeteve të zgjeruara të të folurit për ushtrimet të lidhura me shkathtësitë. Të dyja këto fusha janë me rëndësi të madhe në MGJP, sepse ato ndihmojnë për të udhëhequr nxënësit/et në kompetencën e zhvilluar në gjuhën e parë dhe në një dygjuhësi mundësisht të ekuilibruar; krahaso sipër kreun 2b dhe 2c.

b) Rreth sjelljes së mësueses/mësuesit në të folur dhe në shtruarjen e pyetjeve

Në mënyrë që nxënësit/et t'i zgjerojnë dhe t'i zhvillojnë aftësitë e tyre gjuhësore në të folur, ata kanë nevojë për kohë dhe mundësi të zbatimit të tyre. Se deri në çfarë mase ata do t'i kenë këto, në masë të madhe varet nga sjellja në diskutimet dhe pyetjet e mësimdhënësit. Kur mësuesi A komunikon vetëm në «modusin e pyetjeve» të ngushta tradicionale («Cili është emri i lumit më të gjatë në vendin tonë?», «Ku banonte heroi i tregimit tonë?» etj.), nxënësit e tij gati fare nuk do të përparojnë në aspektin gjuhësor. Nëse mësuesja B, në të kundërtën, në vend të pyetjeve të tilla të ngushta dhe të rreme, i drejtohet klasës me pyetje të hapura ose, edhe më mirë, i drejtohet klasës me nxitje, nxënësit/et do të udhëhiqen automatikisht drejt rezultateve të përparuara gjuhësore në të folur. Shembuj të pyetjeve dhe nxitjeve të tilla janë: «Çfarë keni mësuar në lidhje me lumenjtë dhe liqenet në vendin tonë?», «Diskutoni se çfarë ju pëlqen ose ju pengon në lidhje me sjelljen e heronjve të tregimit tonë!».

Për fat të keq, shumë mësues/e kanë prirje që, në mënyrë intuitive dhe ndoshta edhe për shkak të nevojës së tyre shkollore, të sillen në diskutime dhe pyetje në atë mënyrë që nxënësve/eve u japin shumë pak raste për të folur. Hulumtimet tregojnë se të shprehurit e mësuesve/e me gojë është shpesh 20 deri në 30 herë më i lartë se ai i një nxënësi/e. Për ta përmirësuar këtë situatë në klasën tonë, na ndihmon nëse marrim parasysh pikat e mëposhtme:

-
- Përgjigjet nga nxënësit/et të mos përsëriten (kjo e ashtuquajtura «eho- e mësuesit» vepron në mënyrë zmadhuese dhe parandalon që nxënësit/et të mësohen të flasin me zë të lartë dhe kuptueshëm). Gjithashtu nuk është mirë që në mënyrë të ngjashme, të përdoren pranimet rituale të përgjigjeve si, «mirë», «shumë mirë» «e saktë!» etj. Kjo dëshmon për një stil të vjetëruar të mësimit me mësuesin në qendër.
-

- Kur flasim për tekstet, përmbajtjet faktike, problemet dhe konfliktet, të punohet mundësisht me nxitje bisedimore, ose të paktën me pyetje të zgjeruara, reale (kurse pyetjet e rreme dhe të ngushta të mënjanojnë). Nxitje të tilla për të hyrë në një bisedë dhe për ta vazhduar atë, duhet të mendohen me kujdes gjatë planifikimit; vetëm pas një kohe dhe ushtrimeve të vazhdueshme mund të thuhet se një mësues/e i zotëron mirë këto.
-

- Të bëhen bashkërisht me klasën dhe të ushtrohen rregullat e rrituale, ashtu që një mësues/e t'ia mundësojnë sa më shumë që të jetë e mundur të tërhiqet në prapaskenë. Në diskutimet në grup dhe bisedat në klasë, për shembull, nxënësit/et mund ta caktojnë vetveten, gjegjësisht ta kalojnë fjalën tek tjetri, nëse kjo është ushtruar dhe nëse në fillim ka pasur një nxitje ose një detyrë (dhe jo një pyetje e mësuesit, e cila automatikisht kërkon një përgjigje).
-

- Qëllimit të njëjtë i shërben zgjedhja e formave mësimore më nxënësin në qendër, tek të cilat pozita sunduese dhe pjesa e të folurit të mësimdhënësit të paktën reduktohet (krahaso për këtë doracakun «Bazat dhe arsyet», sidomos kreu 5 dhe 6). Në MGJP, në të cilin mësimdhënësi zakonisht ka për t'i drejtuar disa klasa apo grupmosha në të njëjtën kohë, kjo është pa dyshim një detyrë e vështirë. Por, edhe këtu, mësimi me mësuesin në qendër mund të reduktohet nëpërmjet kalimit të përgjegjësisë tek nxënësit/et.
-

c) Sukseset në të shprehurit me gojë, të vëzhgohen, të vlerësohen dhe qëllimisht të përkrahen

Vëzhgimi dhe vlerësimi i orientuar në përkrahje në të shprehurit me gojë është më i ndërlikuar se ai i teksteve të shkruara. Të dëgjuarit e disahershëm dhe analizimi është i mundshëm vetëm kur punohet me regjistrimet audio ose video. Kjo, në parim, del jashtë cageve të së mundshmes. Të paktën për raste shumë të veçanta do të duhej që edhe kjo metodë sigurisht të realizohet (p.sh. regjistrimi i zërit, ndërsa fëmija lexon një tekst), pasi që kjo çon në rezultate shumë më të sakta.

Për të shmangur mundësinë e vlerësimeve kuturu, dhe në këtë mënyrë pak ndihmuese në fushën e gojëtarisë, këshillohet një qasje e orientuar dhe e mbështetur në kritere, e cila gjithmonë i përshtatet moshës ose nivelit të zhvillimit në gjuhën e parë. Ne i referohemi këtu kreut 7 në doracakun «Bazat dhe arsyet» (Sukseset të vlerësohen duke u orientuar nga përkrahja, me shembuj praktik në pjesën B) dhe i plotësojmë këto me udhëzimet e mëposhtme:

-
- Duke iu referuar situatave «formale», të deklaruara të vëzhgimit dhe vlerësimit (p.sh. tek një referat, një pjesë teatrore, një recitim etj): këtu duhet paraprakisht të caktohen kritere të qarta dhe të komunikohen ato, mundësisht në formën e një table të kriterëve me pika të shumta. Me këtë, vlerësimi i nxënësve/eve është transparent dhe gjithashtu duken menjëherë pikat prej nga duhet të fillohet me përkrahjen për punë të mëtejshme. Gjetja e përshtatshme e ushtrimeve dhe formave të trajnimeve është pjesë e profesionalizmit të mësimdhënësit.

Një tjetër përparësi e fletëve të vëzhgimit me kritere është se nxënësi/ja (të paktën prej klasës së 3) e plotësojnë këtë fletë dhe mund ta përdorin atë për të rritur ndjeshmërinë e tyre ndaj pikave përkatëse. Një shembull i një fletë vëzhgimi për vlerësimin e referateve mund të gjendet në doracakun «Bazat dhe arsyet» në kreun 7 B.1; krahaso më tej edhe broshurën «Përkrahja e të lexuarit në gjuhën e parë», nr. 18 (Tabela për vetëvlerësim gjatë të lexuarit).

-
- Duke iu referuar vëzhgimeve «informale, jo specifike (p.sh. tek grupet apo diskutimet në klasë, referatat e nxënësve/eve, leximet veç e veç apo prezantimet e ngjashme të vëzhguara): kjo ka kuptim, nëse mësuesi edhe në situata të tilla merr shënime për vëzhgimet e veçanta («X duhet të mësojë për t'i dëgjuar të tjerët me kujdes dhe për t'iu përgjigjur atyre», «Y ka probleme me shqiptimin e tingullit <s>», «Z ka bërë përparim të madh në të shprehurit e lirë» etj). Në vazhdim (ose në një kohë më të vonë, të përshtatshme) mësuesi mund t'ua thotë nxënësve/eve përkatës vëzhgimet e veta dhe, nëse është e nevojshme, t'u japë atyre këshilla konkrete për përmirësim.
-

5. Shkëmbimi dhe bashkëpunimi me klasat e rregullta

Se sa i vlefshëm dhe nxitës është një veprim i bashkërenduar mes MGJP dhe klasave të rregullta, si dhe shkëmbimi i përvojave, njohurive dhe procedurave, u theksua disa herë në doracakun bazë, si dhe tek materialet e tjera didaktike të këtyre fletoreve. Me qëllim të përkrahjes së të shprehurit me gojë, para se gjithash, mund të jenë me interes aspektet vijuese:

- Shkëmbime mbi temën edukimi bisedimor: Cilat rregulla të bisedave vlejné për mësuesit/et e ndryshëm; si janë futur këto rregulla, si ushtrohen ato?
- Shkëmbime mbi format metodologjike në kontekstin e edukimit demokratik bisedimor: Çfarë formash (p.sh. këshilli i klasës, diskutime për/kundër etj) janë praktikuar dhe mund të presupozohen?
- Shkëmbimi i ideve dhe materialeve për punë në fushën e lojës skenike (forma të vogla të teatrit të shkollës etj.) dhe të mënyrës së prezantimit të poezive dhe të teksteve të tjera.
- Njohja e ideve dhe materialeve e teksteve gjuhësore të klasave të rregullta dhe të komenteve në to. Këtu gjenden ndoshta materiale konkrete dhe të mira edhe për MGJP të cilat mund të përshtaten si p.sh. format e vëzhgimit dhe të vlerësimit.

Si projekte të bashkëpunimit në mes të arsimit të rregullt dhe atij të MGJP, me theks në të shprehurit me gojë, ofrojnë ndër të tjera, në vijim, qoftë në kuadër të klasës së rregullt apo në kontekstin e një jave të projektit:

- Konceptimi i përbashkët i një serie të leksioneve për poezitë në gjuhë të ndryshme, përfundimi me një takim me prindër; në mënyrë plotësuese edhe një CD me poezi shumëgjuhësore.
- E njëjta gjë, por me lojëra gjuhësore nga gjuhë të ndryshme. Krahazo këtu gjithashtu edhe propozimin mësimor nr. 7.
- E njëjta gjë, por me skena të shkurtra teatrore apo skeçe në gjuhë të ndryshme; eventualisht edhe videoincizim.

- Krahazo më tej edhe ide të ndryshme për lojëra më të vogla gjuhësore dhe veprimtari të tjera në «Shumëllojshmëria si shansë» (Schader, 2013).

Për një vështrim profesional të kësaj hyrjeje i falënderojmë Stefan Hauser dhe Nadine Nell-Tuor nga Qendra e Gojëtarisë e SHLP të Zug-ut dhe Claudia Ulbrich nga Sektori i Pedagogjisë ndërkulturore i Entit të Arsimit të Drejtorisë së Arsimit për Kantonin e Cyrihut.

Pjesa I:
Ushtrimi i tingujve; nxitje për
përdorim krijues gjuhësor

Ushtrimet akustike, pesë ushtrime për diferencim të tingujve

Qëllimi

Ushtrimet vijuese i përkrahin N në shkathtësinë e rëndësishme për t'i shqiptuar saktë të gjitha shkronjat e gjuhës së parë. Varësisht nga gjuha e parë, kjo ka të bëjë veçanërisht me ata tinguj të gjuhës standarde, të cilët N nuk i njohin nga dialekti. (krahaso këtu kreun 1a të hyrjes). Njëkohësisht këto ushtrime ndihmojnë për të zgjeruar leksikun.

KP–kl. 3

5–15 min.



Materiali:

Listat e fjalëve; pasqyrë e vogël; fletë me ilustrime të përshtatshme.

Vërejtje paraprake

Konteksti parësor i ushtrimeve vijuese është mësimi i një tingulli të veçantë në kuadër të alfabetizimit në gjuhën e parë (në fund të klasës së 1-rë ose në fillim të klasës së 2-të). Krahas me ilustrimet shkrimore, natyrisht duhet të ushtrohet edhe shqiptimi i saktë. Është e mundshme, megjithatë, që disa ushtrime në të shqiptuar të bëhen që në kopshtin e fëmijëve, ose këto të përsëriten edhe në klasat e larta, në qoftë se ka ende pasiguri tek to.

a) Ushtrimet në përsëritjet e fjalëve

- M ka një listë të fjalëve para vetes (ose në mendje), në të cilat gjendet tingulli përkatës. Ai/ajo ulet bashkë me një ose disa N dhe ua thotë atyre fjalët në mënyrë të qartë. N i përsërisin qartë ato fjalë, të cilat i thotë M (jo në kor, por secili fëmijë njëri pas tjetrit).
- Varianti: roli i M mund të merret nga një fëmijë më i rritur, shqiptimi i të cilit është pa të meta.

b) Ushtrimet me pasqyrën e xhepit

- Për të rritur ndërgjegjësimin se mund të formohen shumë tinguj, mund të ndihmojë një pasqyrë xhepi. Pasi që M e ka dëshmuar qartë se si duhet të jetë pozicioni i gojës p.sh. te tingulli /m/ dhe te /n/, N e provojnë nyjetimin dhe e kontrollojnë vetveten me një pasqyrë xhepi. Ky ushtrim është i përshtatshëm edhe për punë me partner me një nxënës më të vjetër.
- Te mjaft tinguj ky ushtrim nuk është i dobishëm (p.sh. tek tingujt /d/– /t/). Për këtë këtu mund të ndihmojë që me dorë të ndihet forca e ndryshme e shkarkimit në ajër (më shumë shkarkim ajri tek tingulli /p/ se sa te /b/ etj.)

c) Ushtrimet e identifikimeve dëgjimore dhe dalluese

- Ushtrimet identifikuese: M (ose një fëmijë që është i sigurtë në aspektin gjuhësor) e ka një listë me fjalë përpara, tek të cilat gjendet përkatësisht nuk gjendet tingulli përkatës. Ai/ajo i lexon fjalët para të tjerëve. Tek fjalët të cilat e kanë tingullin e kërkuar, N e ngritin dorën tek të tjerat jo.
- Ushtrimet dalluese: (p.sh. b – p; d – t): një pjesë e fjalëve i ka një ose dy tinguj dallues p.sh. /b/; një pjesë tjetër (p.sh. /p/). N japin sinjalin përkatës (p.sh. nëpërmjet asaj që e ngritin dorën e majtë ose të djathtë ose një letër me shkronjën b përkatësisht p e ngritin lart).



d) Ushtrimet me ilustrime

(në mënyrë të ngjashme si te ushtrimi c)

- Ushtrimet identifikuese: N e marrin një fletë me shumë ilustrime të objekteve, të cilat tingullin, për të cilin bëhet fjalë, e kanë ose nuk e kanë. Në vazhdim duhet t'i shqiptojnë qartë fjalët.
- Ushtrimet dalluese: (p.sh. b – p; d – t): Një pjesë e objekteve të paraqitura e ka njërin nga dy tingujt dallues (p.sh. /b/); një pjesë tjetrin (p.sh. /p/). N e qarkojnë njërin ilustrim me ngjyrë të kuqe e tjetrin me të kaltër. Në vazhdimi i shqiptojnë qartë fjalët.
- Variante: N ulen bashkë në rreth. Në mes në tokë gjenden dy fletë; në njërin qëndron p.sh. «D, d», në tjetrën «T, t». Secili fëmijë i merr 5–7 letra me ilustrime. Me radhë N tregojnë nga një letër. Nëse ajo e ka një tingull të kërkuar, mund ta vendosin tek fleta përkatëse, në të kundërtën e vendosin tek një fletë e bardhë. (Letrat me ilustrime mund të blehen ose të bëhen vetë; këtu mund të ndihmojnë nxënësit/et më të rritur.)

e) Të qarkohet xtingulli në fillim, në mes ose në fund

N e marrin një fletë me p.sh. 12 ilustrime të objekteve. Tek një pjesë e objekteve të paraqitura qëndron një tingull për të cilin bëhet fjalë në fillim, tek disa të tjera në mes e tek disa në fund. Nën secilën figurë janë tri fusha. Në to duhet të kryqëzohet, nëse tingulli i kërkuar gjendet në fillim, në mes ose në fund (shiko ilustrimin).

Ku është r?								
								

2

«Alma thotë ...»

Qëllimi

N ushtrojnë me këtë ushtrim të dëgjojnë me saktësi dhe të kuptojnë të dëgjuarit, ngase këtë tregim ata duhet ta përpunojnë dhe ta zbatojnë shpejt. Njëkohësisht, nëpërmjet lojës, ata mësojnë që t'i ndjekin detyrat që i jep M dhe kështu e përforcojnë leksikun e përvetësuar.

kl. 1–6

5–10 min.



Udhëzime:

Ushtrimi lidhet me lojën për fëmijë «Simon says», e cila është e njohur dhe e përhapur në botë me emra të ndryshëm.

Emri «Alma», vetëkuptueshëm, mund të zëvendësohet me një emër tipik nga gjuha dhe kultura e vetanake.

Rrjedha:

- M ua jep një detyrë të thjeshtë, e cila fillon me «Alma thotë». Shembuj: «Alma thotë: Ecni nëpër dhomë në qetësi.», «Alma thotë: duartrokitni me duar.».
- N mund t'i ndjekin detyrat vetëm nëse ato fillojnë me «Alma thotë». Nëse M e jep një detyrë, e cila nuk është me «Alma thotë» (p.sh. «ejani përpara!»), N duhet ta injorojnë.
- Nëse dikush bie ndesh me këtë rregull d.m.th., reagon ndaj një detyre, e cila nuk fillon me «Alma thotë»), duhet të dalë jashtë lojës, për një kohë të caktuar ose për disa raunde.

Propozime se çfarë mund të thotë Alma:

- ▶ «Alma thotë: Prekeni gjurin e djathtë.»
- ▶ «Alma thotë: Qëndroni mbi një karrige.»
- ▶ «Alma thotë: Ecni si një burrë i vjetër / si një grua e vjetër / si një mbret / si një indian i cili zvarritet / si një majmun»



Variantet:

- Në vend të M detyrat i shpërndan një fëmijë.
- N duhet të bëjnë të kundërtën e asaj që Alma e kërkon. Tek «Alma thotë: Uluni» duhet të ngriten në këmbë.

Qëllimi

N nëpërmjet lojës e përforcojnë leksikun gojor dhe e ushtrojnë kompetencën e shqiptimit dhe të të dëgjuarit.

KP-kl. 6

5–20 min.



Materiali:

Eventualisht një libër me ilustrime.

Udhëzim:

Loja mund të luhet në bashkësinë e klasës, në grup të vogël ose në dysh.

Rrjedha:

- Një fëmijë kërkon me mendje të gjitha objektet që duken në klasë (p.sh. dërrasa e zezë, doreza e derës, llamba...). Ai thotë: «Unë shoh diçka, që ti nuk e sheh.»
- Nxënësit shtrojnë pyetje për këtë, për të gjetur se cili objekt është menduar. Të lejueshme janë pyetjet, të cilave mund t'u përgjigjen vetëm me «po» ose «jo» (p.sh. «A është një mobilje?», «A është e kuqe?»). Me pyetje të shkathta mundet që objekti i mundshëm hap pas hapi të sqarohet. Për shembull: «A është në anën e djathtë të klasës? A është i madh? A është i gjelbër?». Nëse përgjigja është pohuese, atëherë i njëjti fëmijë ka të drejtë të pyesë më tutje; tek «jo» vjen një fëmijë tjetër në rend.
- Sapo një fëmijë e ka zbuluar objektin e kërkuar («A është dërrasa e zezë?» «Po!»), mund ta mendojë nga ana e vet një objekt, të cilin duhet ta zbulojnë të tjerët.

Variantet:

- Përveç se me objekte reale, loja mund të luhet edhe në grupe të vogla me ilustrime, në të cilat janë të paraqitura shumë objekte (shumë të përshtatshme janë të ashtuquajturat «Ilustrime gëluese»).
- N e mendojnë në vend të një objekti, një personalitet të famshëm, një nxënës të klasës, një profesion ose nocione të tjera për një temë më parë të përcaktuar.
- M e fsheh një send, që ka të bëjë me temën mësimore, në një kuti ose diku tjetër. N mundohen të gjejnë se për çfarë po bëhet fjalë. Ky variant është i përshtatshëm për një fillim të orës mësimore (p.sh. mund të jenë syzet e diellit si hyrje në temën «Pushimet»).
- Përveç se me objekte N duhet që me sy të mbyllur të mundohen t'i gjejnë zhurmat ose zërat. Ky variant është i përshtatshëm për të ushtruar aftësinë në të dëgjuar dhe për të përkrahur përqendrimin.

Qëllimi

Ushtrimi e trajnon, në mënyrë të thjeshtë e nëpërmjet të lojës, kompetencën në të folur dhe të kuptuarit e së dëgjuarës. Këtu N mësojnë të njohin më mirë njëri-tjetrin, nëpërmjet asaj që shtrojnë pyetje, dëgjojnë me kujdes dhe përgjigjen në mënyrë adekuate.

kl. 1–9

10–20 min.



Materiali:

Letrat me detyra,
të përgatitura nga M
(2–3 për N).

Udhëzime për literaturën:

Piel (2002), f. 103

(shiko pasqyrën e literaturës).

Rrjedha:

- M i jep secilit N dy deri tri letra me detyra. Në këto letra M i ka formuluar detyrat si për shembull:



- N lëvizin nëpër klasë dhe ia drejtojnë pyetjen nxënësve/eve të tjerë, e cila është e shënuar në letër (natyrisht e riformuluar: «A rrjedh familja jote nga një qytet i madh i vendit tonë të origjinës?» etj.). Nëse dikush e gjen një nxënës/e, që u përshtatet kushteve të kërkuara, e shkruan emrin e tij/e saj në letrën e detyrës (Variante: fëmija përkatës e vë nënshkrimin e tij në letër). Mund të nënshkruhen disa N në të njëjtën letër.)
- Kur të jenë nënshkruar të gjitha letrat (ose p.sh. pas 10 minutash), M e diskuton me klasën se çfarë gjërash të reja kanë mësuar fëmijët për kolegët/et e tyre.

Vërejtje:

- Detyrat duhet të jenë të thjeshta, në mënyrë që të gjithë N të gjejnë dikë.
- Është e arsyeshme që të formulohen 2–3 detyra për nivele të ndryshme, të shpërndara në letra me ngjyra të ndryshme (e gjelbër = e thjeshtë, e kaltër = mesatarisht e vështirë, e kuqe = e vështirë etj.) Letrat pastaj do të shpërndahen varësisht nga mosha apo nga zhvillimi gjuhësor i N.
- Detyrat duhet të përshtaten për klasën përkatëse dhe duke u bazuar në resurset kulturore dhe gjuhësore.
- Letrat me detyra mund të krijohen edhe nga N e vjetër.
- Për t'i përdorur letrat shumë herë, ato mund të palosen ose të futen në çanta të tejdukshme.

Qëllimi

N e aktivizojnë leksikun e tyre perceptues dhe produktiv në të shprehurit me gojë, nëpërmjet asaj që i përshkruajnë dhe i zbulojnë fjalët. Njëkohësisht ata e ushtrojnë dhe e zgjerojnë repertorin e tyre për modelet e fjalive në gjuhën e parë.

kl. 3–6

10–20 min.



Rrjedha:

- M e ndan klasën në dy grupe njësoj të forta (A dhe B). Ai i cakton dy N, të cilët mund të ulen të parët në «vendin e nxehtë». Për këtë, para dërrasës së zezë qëndrojnë dy karrige; ato janë të drejtuara nga klasa. Njëri N e përfaqëson grupin A, tjetrin grupin B.
- M e shkruan një fjalë në dërrasë (p.sh. «ëmbëlsirë» ose «kryeqyteti ynë» ose «zvarritem»). Këtu duhet të bëhet fjalë për një nocion, të cilin e dinë të gjithë N. N në vendet e nxehta shikojnë në drejtim të klasës dhe nuk kanë të drejtë të shohin fjalën.
- Kur M jep komandën, fillojnë të dy grupet që t'ua përshkruajnë përfaqësuesve të tyre fjalën e shkruar në dërrasë, por ata nuk kanë kursesi të drejtë që fjalën ose rrënjën e fjalës ta shqiptojnë (nëse kjo ndodh atëherë grupi përkatës ka humbur). Kjo mund të shkojë kështu p.sh. shokët e klasës i pëshpëritin me rend aludime e udhëzime shokut në vendin e nxehtë. Të dy N në vendin e nxehtë përpiqen, që ta zbulojnë fjalën në dërrasë në bazë të udhëzimeve që i dëgjojnë.
- Sapo njëri nga N në vendin e nxehtë fjalën e kërkuar i pari e shqipton, grupi përkatës ka fituar.
- Pastaj vazhdohet të luhet më tutje me një fjalë tjetër dhe me N të tjerë në vendin e nxehtë.

Variantet:

- Do të zgjidhen qëllimisht nocione në lidhje me MGJP ose me temën faktike aktuale (Shembull: Ujërat në vendin e prejardhjes; personalitetet nga historia). Në këtë mënyrë loja mund të shërbejë edhe si hyrje në një temë të re. Nëse kjo është e vështirë për N e rinj, ky variant mund të luhet vetëm me më të vjetrit, kurse për më të vegjlit M e zgjedh një formë më të thjeshtë.
- N i zgjedhin vetë fjalët, ose tërësisht në mënyrë të lirë apo për një temë, të cilën M e jep më parë. Pastaj M i përzgjedh fjalët e përshtatshme nga propozimet e N.

Qëllimi

Puna me vargjet, rimat dhe poezitë është shumë e vlefshme për fushat e ndryshme të zhvillimit gjuhësor (shqiptimi, leksiku, repertori sintaksor, arsimimi letrar etj.) Kjo mund të përdoret në të gjitha nivelet, nga rimat e thjeshta në kopshtin parashkollor e deri te marrja me lirikën në nivelin e lartë. Nxitjet pasuese kufizohen në mësimin e vargjeve për fëmijë dhe rimat në kopshtin parashkollor dhe në klasat e ulta.

KP–kl. 3

10–15 min.



Materiali:

Vargje të përshtatshme, rima dhe poezi.

Udhëzime:

- Vargjet për fëmijë dhe rimat, ashtu siç i njeh çdo kulturë, janë më të rëndësishme për zhvillimin gjuhësor sesa që mund të duket në shikim të parë. Me strukturën e tyre ritmike, stimuluese për t'i rithënë, ato ndihmojnë që jo vetëm fjalët, por të gjitha shprehjet të mësohen në formë loje, gati sugjестive. Nëpërmjet të kësaj ndihmojnë për zhvillimin e shqiptimit, leksikut dhe strukturave gjuhësore.

E njëjta vlen edhe për klasat e larta në punën me poezitë. Këtu nxënësit/et do të njihen jo vetëm me një pasuri të rëndësishme të kulturës së tyre. Shumë më tepër, në bazë të teksteve lirike, ata mësojnë njëkohësisht t'i njohin mundësitë e veçanta dhe nuancat e përdorimit të gjuhës, të cilat qëndrojnë më larg sesa ato gjëra që i njohin nga jeta e përditshme. Për t'ua vënë atyre në shfrytëzim këto mundësi dhe përmasa, nuk është një punë e lehtë, por një detyrë e rëndësishme dhe e bukur. Se sa mirë dhe me sukses mund të zotërohen këto, tregojnë, ndër të tjera, recitimet mbresëlënëse të shumë klasave nga MGJP të Evropës Juglindore. Krahase edhe më poshtë nr. 29.

- Udhëzim për literaturë: Silvia Hüsler (2009) (shiko pasqyrën e literaturës).

Rrjedha e mundshme:

- N ulen ose shtrihen çlodhshëm dhe i mbyllin sytë.
- M e reciton vargun ose rimën ngadalë dhe qartë e me zë të lartë.
- Pastaj ulen të gjithë në rreth. Bashkërisht do të bisedohet se çfarë kanë dëgjuar N, cilat fjalë nuk i kuptojnë dhe cilat përfytyrime të brendshme janë shpërfaqur.
- Varësisht nga forma e rimës do të përpunohen bashkërisht gjestet, lëvizjet etj., të cilat i përshtaten prezantimit të vargut.
- M e paraqet edhe njëherë vargun ose rimën dhe bën edhe veprime për këtë. Fëmijët i përsërisin lëvizjet e M.
- Nëse duan fëmijët, mund edhe ata të flasin dhe të veprojnë. Në një fazë përfundimtare mësuesi mund të tërhiqet plotësisht.

Variantet:

- Prezantimi nëpërmjet të të folurit të vargut/rimës në një kohë të caktuar: Nëse vargu/rima do të shërbejë si një ndihmë e qëlluar gjatë rregullimit të klasës, është e dobishme, që në këto situata të deklamohet. Nëpërmjet kësaj fëmijët e mësojnë vargun në mënyrë të pavetëdijshme dhe do ta thonë pas një kohe edhe vetë.
- Prezantimi nëpërmjet ilustrimeve (p.sh. tek vargjet për kafshët): M kërkon ilustrime të përshtatshme, të cilat mund të përdoren si ndihmë orientuese dhe përkrahëse.
- Për të ndryshuar pak, është e mundur që prezantimi i vargjeve apo i rimës ndonjëherë të bëhet edhe nga ndonjë N më i rritur.

Vërejtje:

- Vargu/rimë duhet të përsëritet shumë herë, në mënyrë që fëmijët pastaj me kohë të mund ta thonë vetë.
- Lëvizjet dhe gjestet ndihmojnë për t'i mbajtur mend fjalët. Ato ndihmojnë për t'i përkrahur mendimet, në të cilat mund të orientohen fëmijët, kur nuk e dinë se si shkon më tutje vargu/rima.

7

Vargje të shqiptuara shpejt, lojëra gjuhësore

Qëllimi

Vargjet e shqiptuara shpejt (në gjermanisht të quajtuara si thyerje e gjuhës ose sqepmprehës, në anglisht Tongue Twisters) bashkë me vargjet e tjera për fëmijë (shiko lart nr. 6) dhe lojërat e vogla gjuhësore, i përkasin pasurisë gjuhësore gati në të gjitha gjuhët. «Puna» me to bëhet nëpërmjet lojës dhe është zbavitëse, e njëkohësisht përkrahet të dëgjuarit e vëmendshëm dhe shqiptimi i saktë.

KP-kl. 3

5–10 min.



Materiali:

Vargje të shqiptuara shpejt në gjuhën amtare; të mbledhura nga M dhe nga N.

Udhëzime për literaturën:

Vargje të shqiptuara shpejt në gjuhë të ndryshme gjenden p.sh. në <https://www.heilpaedagogik-info.de/zungenbrecher/287-zungenbrecher-deutsch-sprueche.html>

Rrjedha:

- M reciton vargje të shqiptuara shpejt para N dhe i ushtron ato pjesë pjesë me ta.
- N i ushtrojnë vargjet e shqiptuara shpejt për vete, në dysh ose në grupe.

Variantet:

- M i reciton para N vargjet e shqiptuara shpejt 2–3 herë dhe kërkon nga ata që, në bazë të të kuptuarit e asaj që kanë dëgjuar, ta rithonë vetë (prezantim më pak sistematik se sa më lart).
- N i sjellin vetë vargjet e shqiptuara shpejt dhe ua mësojnë ato fëmijëve të tjerë.
- Një kuadër të shkëlqyer ofron një projekt përmbledhës, në të cilin të gjithë N pyesin në shtëpi dhe tek të afërmit për vargje të shqiptuara shpejt dhe lojëra të ngjashme gjuhësore dhe i shkruajnë ato. Si fryt i kësaj përmbledhjeje mund të bëhet një libërth ose një audiofile (CD, MP3). Ky projekt mund të bashkërendohet mirë edhe me mësimin e rregullt ose me grupet tjera gjuhësore, karahaso kap. 4 në hyrje.

Vërejtje:

- Vargjet e shqiptuara shpejt janë me kërkesa të larta. Edhe të rriturit dhe N me aftësi të mira gjuhësore në të folur kanë në fillim vështirësi me to dhe duhet të përqendrohen mirë. Megjithatë, ato janë të përshtatshme për një hyrje të shkurtër, argëtuese në një orë mësimore ose si thyerje e monotonisë në mes apo në fund të një ore mësimore.
- Në mënyrë që kompetencat e fëmijëve të rriten në bazë të formulimit të qëllimeve, është me rëndësi që, pavarësisht nga karakteri i tyre si lojë, të bëhen përpjekje për një përsëritje sa më korrekte.

Qëllimi

Lojërat e roleve ndikojnë në shtendosjen e mësimit, udhëheqin në të kuptuarit e thellë të situatave dhe teksteve dhe përbëjnë një formë të shkëlqyer të ushtrimeve gjuhësore. Fëmijët mësojnë këtu që ta prezantojnë vetveten, të argumentojnë, ta modelojnë gjuhën dhe ta përdorin në mënyrë ndikuese.

KP–kl. 3

10–25 min.



Materiali:

Eventualisht disa rekuizita të vogla.

Udhëzim:

Ndryshe nga numrat më të kërkuar poshtë 26–28 (lojëra gati reale, lojëra fiktive, lojëra teatrore), tek propozimi vijues bëhet fjalë për format e thje shta, të përcaktuara nga vetë fëmijët, d.m.th., lojëra rolesh, ashtu si parapëlqehen të luhen në MGJP me grupin e më të vegjëlve.

Rrjedha:

- M i formon grupet me nga 2–3 N, të cilët pastaj e mendojnë një skenë loje dhe do ta luajnë atë. Fëmijët e suksesshëm dhe fëmijët me sukses të dobët do të duhej të shpërndaheshin në atë mënyrë që grupet të mund të bashkëpunojnë mirë dhe të gjithë N të jenë të përfshirë.



- Detyra për grupet: «Mendojeni një skenë bisedimore nga përditshmëria, të cilën ju bashkërisht do ta përpunoni». Ndoshta janë të nevojshme nxitje plotësuese: mund të luhet diçka argëtuese, një skenë nga pushimet në vendin e prejardhjes, një keqkuptim gjuhësor, diçka nga shkolla... skena mund të zgjatë më së shumti 5 min.
- Grupet përgatiten rreth 10 min. pastaj ia luajnë skenën njëri-tjetrit ose tërë klasës së tyre. N e tjerë e japin një Feedback për një radhë pyetjesh të përgatitura, si p.sh.: Pse na ka pëlqyer kjo skenë, pse jo? Si ishte forma e prezantimit dhe kuptueshmëria? Çfarë na bëri përshtypje tek gjuha?

Variantet:

- Në vend të një skene nga përditshmëria mund të jepen edhe situata të tjera: diçka nga bota e përrallave, diçka nga e ardhmja (kur ju do të jeni 50 vjeç), diçka nga bota e kafshëve etj. Krahaso këtu edhe numrat 26–28.
-

Vërejtje:

- Është me rëndësi të jepen detyra të qarta: kohëzgjatja për parapërgatitje dhe lojë; të mos ketë skena të rrahjes dhe të vrapimeve, sa më shumë që të jetë e mundur të ketë skena ku do të flitet.
- Koha e nevojshme, që shfrytëzohet për këtë ushtrim, mund të ndryshojë sipas dëshirës. Nëse planifikohet më shumë kohë, atëherë dialogjet mund të jenë më të gjata dhe grupet më të mëdha. Përveç kësaj, dialogjet mund të zgjerohen me rekuizita dhe pjesë të vogla të skenave.

Pjesa II:
Të sjellurit në mënyrë të
përshtatshme në biseda –
në çift dhe në grupe

9

Të merremi vesh për rregullat e bisedave dhe t'i ushtrojmë ato

Qëllimi

N i zbulojnë dhe i ushtrojnë rregullat, të cilat janë me rëndësi për mbarëvajtjen e bisedave në çift dhe në grupe. Ata e zhvillojnë këtu kompetencën e tyre komunikuese dhe sociale dhe mësojnë të sillen në mënyrë të përshtatshme në gjuhën e tyre të parë edhe në kuadër të diskutimeve në grupe etj.

kl. 2–9

15–30 min.



Materiali:
Evtl. një pllakat.

Udhëzime:

- Si parakusht, që bisedat dhe diskutimet produktive të jenë të mundshme, është që të zbatohen disa rregulla të bisedave dhe mënyra e sjelljes demokratike. Kjo vlen në jetën private, por posaçërisht edhe në kontekst të shkollës, ku edukimi për biseda paraqet një prej fushave të qëllimshme të edukimit social dhe gjuhësor. Është e kuptueshme që ndërtimi i një kulture përkatëse paraqet një proces të gjatë, në të cilin do të punohet gjithnjë.
- Përveç rregullave të qarta për N ka një dimension të dytë, gjithashtu të rëndësishëm. Ky dimension ka të bëjë me M dhe sjelljen e tij në biseda dhe raunde diskutimesh. Kreu 4b në hyrje merret me këtë; ne kujtojmë si fjalë kryesore këtu vetëm vetëpërmbajtjen nga ana e M, formulimin reflektues të shtysave dhe pyetjeve të hapura, delegimin e funksioneve të moderimit tek N.

Struktura dhe elementet kryesore të edukimit bisedimor:

- Si pikënisje për këtë mund të jetë më së miri një situatë autentike, në të cilën p.sh. është penguar komunikimi, nga fakti se dikush gjithnjë i ka ndërprerë ose i ka sulmuar në mënyrë të padrejtë të tjerët. Në situata të tilla, biseda mund të fillohet me pyetjen «Si mund të diskutojmë më mirë dhe në mënyrë të barabartë me njëri-tjetrin?»
- Do të diskutohen dy ose tri rregulla (jo më shumë!), do të merren vesh për to dhe do të shënohen në një pllakat. Me rëndësi është që, këto rregulla, të jenë formuluar nga vetë nxënësit e jo të jenë të dhëna paraprakisht nga M. Me shumë gjasa N janë të njohur nga mësimi i rregullt me temën kultura e bisedimit dhe e rregullave. Shembuj nga rregullat e bisedimit i gjeni më poshtë.
- Në dy-tri javët e ardhshme, rregullat do të ushtrohen shumë herë. Për këtë mund të caktohet dikush nga klasa si përgjegjës/e; ai ose ajo mund të ndërhyjë menjëherë, nëse dikush nuk i përmbahet një rregulli.
- Në muajt në vijim rregullat do të zgjerohen, përsosen dhe ushtrohen ashtu siç u tha më lart.
- Duhet të bëhen rregullisht diskutime për çështjen se si ka ndryshuar kultura e bisedimit dhe ku shohin N potencial për përmirësime.
- Disa rregulla mund të përkrahen nga ndihma të vogla strategjike; krahaso shembujt më poshtë.

Shembuj nga rregullat e bisedimit:

- Unë flas me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë.
- Unë e dëgjoj folësin ose folësen.
- Unë nuk e ndërpres askënd.
- Nëse unë dua që të marr fjalën, e ngre dorën.
- Unë i respektoj mendimet e shokëve/eve të klasës.
- Unë nuk përqesh apo tallem me askënd për shkak të mendimit të tij.
- Unë nuk largohem nga tema e diskutimit.
- Unë lidhem me atë çka folësi/ja i mëparshëm ka thënë.
- Unë i shikoj në sy shokët e mi/shoqet e mia kur flas.

Shembuj nga «Strategjitë përkrahëse» për zbatimin e rregullave të caktuara:

- Për rregullën që nuk duhet të ndërpritet askush: fëmija i cili flet, mban një top apo një gur në dorën e tij. Kur ka mbaruar së foluri, ia jep topin një fëmije tjetër, i cili është caktuar më parë. Pra, është e qartë se flet vetëm fëmija, që e mban topin në dorë.
- Për dëgjimin aktiv ose për rregullën që duhet t'i referohemi folësit/es të mëparshëm: gjatë 2–3 diskutimeve duhet që çdo votë të fillojë me «Xy ka thënë se unë personalisht e shoh këtë kështu: ... ». Krahaso, gjithashtu, më poshtë nr. 12 me pjesë të veçanta të fjalive për këtë.
- Varianti për të dëgjuarit aktiv: Secili/a N duhet që gjatë diskutimit të pyesë, të paktën një herë, për diçka që nuk e ka kuptuar mirë («XY, a e kam kuptuar saktë këtë: a mendon se ...?»).
- Strategjitë ndihmëse në mënyrë që M të mund të tërhiqet nga pozita e tij qendrore:
 - a) N e caktojnë vetveten (ose e japin topin më tutje, shih më lart).
 - b) Te çdo diskutim i madh përcaktohet një fëmijë nga klasat e larta, si një drejtues/e. Ky fëmijë përgatitet bashkë me M për diskutimin, formulon pyetjet fillestare ose nxitjet dhe drejton rrjedhën e mëtejshme. M ndërhyr vetëm në rast emergjence. Krahaso këtu gjithashtu poshtë nr. 14 dhe 15.
- Strategjia ndihmuese në mënyrë që mundësisht të gjithë të marrin pjesë në diskutim: Çdo fëmijë i merr tri pulla, kapëse letrash, apo copëza letre. N ulen në një rreth; kush e ka dhënë një ndihmesë për debatin, e vë një pullë në mes në dysheme. Qëllimi është që të gjitha pullat të jenë vendosur në mes. Kjo metodë parandalon që disa N të thonë shumë dhe të tjerët shumë pak.

Qëllimi

N mësajnë për të fituar një vështrim të përgjithshëm mbi një temë dhe të planifikojnë se si ata mund të shprehën në mënyrë të veçantë në gjuhën e parë. Ushtrimi është praktikisht i barazvlershëm me të folurit në raport me planifikimin e një teksti të shkruar; krahaso në broshurën «Përkrahja e të shkruarit në gjuhën e parë», numrat 8–10, 13, FP1, 16. Shih gjithashtu më poshtë nr. 11 dhe nr. 22.


kl. 1–4

20–45 min.



Rrjedha:

- M e bën të njohur temën e bisedës (p.sh., «Koha e lirë në vendin tonë të prejardhjes dhe këtu» ose «Ku dua të jetoj unë pas 20 vjetësh?»).
- N kanë kohë 5–10 minuta. Ata duhet të mendohen nëpërmjet një pune individuale, se çfarë mund dhe dëshirojnë të trajtojnë në temën e bisedës. Mendimet e tyre duhet t'i mbajnë si shënime ose në formën e një vizatimi, një harte mendimesh ose të një kllasteri (për kllasterin dhe hartën e mendimeve shiko nr 8.1 dhe 8.2, në broshurën «Përkrahja e të shkruarit në gjuhën e parë»). Në të njëjtën kohë, ata duhet të mendojnë se në çfarë renditje duan që këto mendime dhe ndihmesa t'i paraqesin në bisedë.



- Pastaj N i shkëmbejnë mendimet e tyre nëpërmjet një pune me partner. Në këtë sekuencë do të tematizohen paqartësitë, duke i përfshirë edhe pyetjet që janë të lidhura me gjuhën e parë.
- Në një raund me tërë klasën, do të sqarohen pyetjet dhe në tabelë ndoshta do të përmbledhet së bashku një fjalorth bazë për temën për të cilën do të bisedohet. Kjo duhet, nëse është e mundur, të përmbajë edhe mjete argumentuese të të shprehurit («Unë e shoh atë ...»; «Sipas mendimit tim ...» etj., shih kreun 2c në hyrje).
- Me tërë klasën ose në grupe të vogla do të udhëhiqet biseda për temën e përcaktuar më lart, kjo natyrisht në përputhje me rregullat e bisedës të përcaktuara deri atëherë (shih më lart, nr. 9).
- Në vazhdim duhet të bëhet një diskutim i shkurtër për cilësinë e bisedës dhe për problemet eventuale, edhe të aspektit gjuhësor.

11

«Think – Pair – Share»: Një procedurë alternative për t'u përgatitur për një bisedë në grup

Qëllimi

N do të përkrahen nëpërmjet një procedure të të mësuarit në bashkëpunim, në mënyrë që të fitojnë një vështrim të përgjithshëm për bisedën dhe të planifikojnë ndihmesat e tyre për temën në mënyrë të bashkërenduar.

kl. 1–6

15–40 min.



Udhëzim:

- «Think – Pair – Share» është një formë e njohur dhe e përdorur gjerësisht në të mësuarit bashkëpunues. Ajo përbëhet nga tre hapa:

1. (vetë) për të menduar,
2. rezultatet të diskutohen në dyshe ose treshe,
3. rezultatet e përbashkëta të paraqiten para tërë klasës.

E zbatuar në fushën e edukimit bisedimor, ajo ndihmon që procesi, mendimet dhe ndihmesat të sqarohen dhe të planifikohen para diskutimit dhe, pastaj, ato të sillen për diskutim në grup.

- Kjo procedurë është e lidhur ngushtë me procedurën e paraqitur më lart te nr. 10. Ne e sjellim atë si numër të veçantë, veçanërisht me synimin për ato klasa, të cilat «Think – Pair – Share» tashmë e njohin nga kontekste të tjera (nga mësimi i rregullt, nga lëndët e tjera). Këtu mundet dhe duhet që të tri fazat të emërtohen veçanërisht qartë dhe të dallohen.

Rrjedha:

- M e prezanton temën e bisedës (shih shembujt më lart në nr. 10).
- Faza e «Think»: N shkruajnë nëpërmjet punës individuale vlerësimet e tyre mbi temën e bisedës në një fletë shënimesh. Pyetjet e mundshme fthilluese për N (të shkruhen në dërrasë të zezë):
 - Cila është tema e bisedës? Cili është qëllimi?
 - Çfarë mendimesh dhe përfytyrimesh të vijnë në mendje për këtë temë?
 - Cilat janë përvojat që ke pasur me këtë temë?
 - Çfarë tashmë di në lidhje me këtë temë?
 - Çfarë është e rëndësishme për ty në këtë temë?
 - Cilat pyetje të interesojnë ty në këtë temë?
- Faza e «Pair»: N sqarohen në grupe dyshe ose treshe, me ndihmën e shënimeve dhe vlerësimeve të tyre. Ata përpiqen për t'i pakësuar pështjellimet, duke pyetur dhe sqaruar. Edhe pyetjet dhe problemet e lidhura me gjuhën e parë (nacione që mungojnë etj.) do të trajtohen.
- Faza «Share»: N ulen në rreth; ata shprehin mendimet e tyre, përvojat ose pyetjet në grupin e bisedës (tërë klasa, grupe nivelesh). Drejtimi i raundit të diskutimit mbetet te M ose – nëse është e mundur – te një fëmijë.
- Eventualisht «metadiskutim» a) për hapat e pjesshëm të procesit veç e veç, b) për cilësinë e bisedës dhe për ndonjë problem eventual. Këtu duhet të bisedohen gjithsesi edhe pyetjet dhe vështirësitë gjuhësore (çfarë mund të përmirësohet në vështrim të kompetencës në të folur në gjuhën e parë; si?).

Qëllimi

Ushtrimi i shtjellon dy kompetenca të rëndësishme të komunikimit: 1.) të dëgjuarit e vëmendshëm dhe 2.) aftësinë për të parë marrëdhëniet e brendshme, gjegjësisht koherencën në një diskutim.

kl. 3–9

30 min.



Materiali:
Shirita të mëdhenj letre
ose pllakat për pjesë të
ndërtimit të fjalive.

Udhëzim:

Ushtrimi i referohet një rregulli të rëndësishëm të bisedës, i cili është kështilluar më lart në nr. 9 («Unë lidhem me atë çfarë ka thënë folësi/ja i mëparshëm»). Kjo i përkrah N me mjetin ndihmës të pjesëve të ndërtimit të fjalive, që këtë rregull ta zbatojnë dhe ta përdorin. Për të punuar me pjesë të ndërtimit të fjalive, krahaso kreun 2c «Mjetet e zgjeruara të të folurit» në hyrje.

Rrjedha:

- M sqaron se një bisedë e mirë, e ndërlidhur mund të kryhet nëse pjesë-marrësit/et i referohen njëri-tjetrit, për shembull, nëpërmjet asaj që lidhen me ndihmesat e folësve të mëparshëm. Ai/Ajo për këtë i përpunon me N mjetet e mundshme të të folurit, gjegjësisht pjesë të fjalive në shirita letre ose në pllakat.
- Për të testuar M bën një pohim dhe i nxit N që, me fillimet e shënuara të fjalive, të lidhen me atë (për shembull, «Unë mendoj se ka kuptim që telefonat celularë nuk janë të lejuar gjatë orëve të mësimi»). Ky ushtrim përsëritet me mëtime të tjera, derisa N e kuptojnë parimin.
- Në 2–3 grupet ose në bisedat e ardhshme të klasës do të shikohet me vëmendje që të bëhet lidhja me folësin e mëparshëm nëpërmjet të fjalive të paradhëna ose me ato personale. Pas çdo bisede do të pasqyrohen përvojat me pjesët e fjalive: cilat pjesë të fjalive ishin veçanërisht të dobishme? A ka ndonjë grup tjetër të pjesëve të fjalive të cilat ne mund t'i përdorim?

Shembuj të pjesëve të fjalive për referim dhe lidhje:

- Unë dua të pyes XY diçka: ...
- Lidhur me këtë unë do të doja të them në vijim: ...
- XY ka pohuar / thënë se ... por ...
- Unë jam i të njëjtit mendim si XY. Edhe unë mendoj se ...
- Me atë çfarë XY ka thënë, unë nuk pajtohem, sepse ...
- Për këtë çfarë XY mendon, unë do të doja të shtoj: ...
- Nëse unë të kam kuptuar ty si duhet ...
- Unë them me plot gojën se ...
- Unë kam mësuar se ...
- Unë mendoj se është mirë/ keq që ... / Mua (nuk) më pëlqen, nëse ...

13

Të japësh Feedback

Qëllimi

N mësojnë dhe ushtrojnë që në mënyrë konstruktive të merren me Feedback-un. Ata mësojnë që ta formulojnë në mënyrë të saktë, me qëllim të caktuar dhe mirëdashës, kurse me Feedback-un, të cilin e marrin prej të tjerëve, të merren në mënyrë pozitive dhe kritike.

kl. 3–9

15–25 min.



Materiali:

N duhet të kenë në dorë tekste të shkurtra (afro ½ e faqes) të cilat më parë i kanë shkruar (Variantet shikoj poshtë).

Udhëzime:

- Marrëdhënia konstruktive me Feedback-un është një prej elementeve thelbësore të një kulture të mirë të bisedës. Në mënyrë që N këtu të përkrahen në mënyrë të qëndrueshme, natyrisht duhet që ushtrimet përkatëse të përsëriten dhe të ndryshohen disa herë.
- Është e rëndësishme, që me fëmijët të merremi vesh paraprakisht për rregullat e Feedback-ut. Dy rregulla fillestare janë si më poshtë:
 1. Feedback jepen në formën-unë (Shembuj: «Unë mendoj se ...», «Mua [nuk] më pëlqen që...»)
 2. Opinionet duhet të arsyetohen (Shembuj: «Unë mendoj se teksti është i mirë, sepse ...», «Mua më pengon që ti ...», «Sepse ti ...»).

Rrjedha:

- N ndahen në grupe dyshe. Fëmija A ia lexon fëmijës B tekstin e tij.
- Fëmija B dëgjon me kujdes dhe u kushton vëmendje mendimeve dhe ndjenjave të tij.
- Fëmija B u përgjigjet për vete me fjalë shumë të shkurtra çështjeve kryesore, të cilat janë të përshtatshme për Feedback-un e tij. Këto mund të jetë ose kritere për të cilat është rënë dakord për tekstin në fjalë, ose pyetje të përgjithshme, të tilla si: «Ajo që më pëlqen në lidhje me punën tënde, ajo që nuk më pëlqen edhe aq?», «Çfarë do të kisha lënë patjetër kështu, çfarë unë do të ndryshoja/përmirësoja?».
- Fëmija B i jep një feedback fëmijës A nëpërmjet të asaj që i riformulon shënimet e tij.
- Ushtrimi përsëritet me ndërrimin e roleve.
- Eventualisht diskutim në fushën e përvojës: Çfarë shkoi mirë/deri diku mirë tek dhënia e feedback-ut; si e përjetova unë vetë feedback-un, që mora?

Variantet:

- Në vend se në raport me një tekst, feedback-u mund të jepet edhe me një vizatim, një referat ose me ndonjë punë tjetër.
- Feedback-u mund të jepet edhe në grupet e mëdha. Nëpërmjet kësaj rritet numri i shpërfaqjeve. Në të njëjtën kohë krijohet mundësia që feedback-u të komentohet vazhdimisht dhe, me këtë mënyrë, edhe të përmirësohet cilësia e tij.

Qëllimi

Nëpërmjet asaj që N (në vend të M) i marrin përsipër detyrat tek drejtimi i bisedave, ata i ushtrojnë kompetencat e tyre në të folur dhe në të dëgjuar. Në mënyrë plotësuese ata përkrahen në pavarësinë e tyre, në kompetencën sociale dhe në ushtrimin e sjelljes demokratike.

kl. 4–9

30–45 min.



Materiali:
Kartat e roleve,
të përgatitura nga M ose
të punuara në mësim.

Rrjedha:

- M sqaron se shpërndarja e qartë e roleve të bisedës mund të ndihmojë në cilësinë e diskutimit. Më pas, rolet veç e veç do të diskutohen dhe letrat do të modelohen me detyrat përkatëse (nëse nuk janë përgatitur tashmë nga M, modeli i një karte roli shih më poshtë). Shembuj të roleve gjegjësisht funksioneve:
 - **Udhëheqësi/ja i bisedës:**
Përkujdeset që N të mbeten në temë, ka një vështrim të përgjithshëm dhe përgjigjësinë kryesore (rol me kërkesa të larta).
 - **Shkruesi/ja:**
shënon rezultatet e mundshme të grupit (rol me kërkesa të larta.).
 - **Kujdestari/ja e kohëzgjatjes së të folurit:**
Shikon që të gjithë të kenë mundësinë të flasin, gjegjësisht që ndonjë N të mos e sundojë bisedën (rol me kërkesa të larta).
 - **Kujdestari/ja i rregullave:**
Përkujdeset për zbatimin e rregullave të rëndësishme të bisedës, p.sh. «Vetëm një fëmijë flet» ose «Askush nuk guxon të përqeshet» (rol me kërkesa të mesme).
 - **Kujdestari/ja e kohës:**
Është përgjegjës për zbatimin e kohës së paraparë (rol i lehtë).
- Rolet e bisedës u caktohen N në bazë të aftësive të tyre. N marrin për këtë një letër roli, me rolin e tyre dhe detyrën përkatëse.
- Rolet do të provohen në bazë të një bisede të shkurtër e të thjeshtë.
- Biseda do të realizohet në bazë të pyetjeve: Çfarë është bërë mirë? Çfarë duhet ende për të përmirësuar?

Vërejtje:

- Rolet duhet t'i përshtaten grupit dhe temës së bisedës. Çdo rol duhet të sjellë një përfitim të vërtetë për bisedën në grup. Për shembull, është e panevojshme për të caktuar një udhëheqës që flet me zë të lartë, nëse grupi me lartësinë e zërit nuk ka ndonjë problem.
- Të gjitha rolet janë të rëndësishme, por ato kanë kërkesa të ndryshme. Nëpërmjet kësaj të gjithë N e kanë rastin për të dhënë një ndihmesë aktive.

Shembull i letrës së roleve për udhëheqësin/en e bisedës:

Udhëheqësi/ja i bisedës	
1.	Ti e fillon bisedën. <i>«Qëllimi i bisedës sonë të sotme është ...»</i>
2.	Ti e shtron një pyetje ose kërkon mendimet e të tjerëve. <i>«Për çka kemi nevojë ne, për ta arritur këtë qëllim?»</i>
3.	Ti përkujdesesh që pjesëmarrësit/et e bisedës t'i përmbahen temës. <i>«Kjo tash nuk i përshtatet temës.»</i>
4.	Ti shtron pyetje të vijueshme, nëse diçka nuk është e qartë. <i>«Çfarë mendon ti me ...?»</i>
5.	Ti e përfundon bisedën! <i>«Sot jemi marrë vesh, që ...»</i>
6.	Ti e shtron një pyetje përfundimtare për bisedën: <i>«Çfarë mendoni ju, a ka rrjedhur mirë biseda? Çfarë mund të bëjmë më mirë herën tjetër?»</i>

15 Udhëheqja e bisedës të merret përsipër

Qëllimi

Ushtrimi paraqet një formë të thjeshtëzuar të nr. 14 dhe ndjek qëllime të ngjashme në fushën e edukimit bisedimor, të sjelljes demokratike dhe të të folurit të lirë. Duke u kufizuar vetëm tek një rol (udhëheqës/e i bisedës) kjo është e përshtatshme për N më të rinj (nga klasa e 2) dhe për raunde të bisedave të shkurtra.

kl. 2–4

15–30 min.



Rrjedha:

- Parakusht për këtë është që ose të jetë e caktuar një temë (qoftë nga M ose nga N), ose që M të ketë përgatitur një listë të mundshme me temat e diskutimit, të përshtatshme për moshën e N, nga të cilat ata mund të zgjedhin njërin.
- M sqaron se udhëheqjen e bisedës do t'ia kalojë N. Kush dëshiron të provojë njëherë këtë? Për çfarë duhet të kihet kujdes vallë, gjatë udhëheqjes së bisedës? (Pikat kryesore: Përgatitja e pyetjeve nxitëse dhe shtysave; pasja parasysh e afatit kohor, zbatimi i rregullave të bisedës, të miratuara më parë.)
- Fëmija, që pranon të udhëheqë bisedën, mund të përgatitet shkurtimisht (5 min.) dhe shënon disa pyetje nxitëse dhe shtysa për bisedë. M duhet ta këshillojë patjetër në këtë punë.
- Fëmija e fillon bisedën, nëpërmjet asaj që i shënohet në tabelë: temën dhe qëllimet dhe i paraqet shënime të tij.
- Në bazë të shënimeve do të udhëhiqet biseda nga fëmija udhëheqës.
- Në përfundim do të pasqyrohet shkurtimisht rrjedha e bisedës dhe përvojat me udhëheqësin.

Variantet:

- Udhëheqja e bisedës nga N mund të merret edhe nga dy N.
- Duhet që të gjithë N të kenë mundësinë që të marrin përsipër njëherë udhëheqjen e bisedës. Natyrisht për këtë janë të nevojshme disa biseda. Është e mundshme që pas 5–10 minutash roli të jepet më tutje.
- Udhëheqja e bisedës nga N mund të ushtrohet dhe zbatohet edhe në formën e këshillit të klasës etj.

16

Planifikimi i bisedës

Qëllimi

Gjatë planifikimit të bisedës N i ushtrojnë aftësitë e tyre në gjuhën e parë dhe të kuptuarit e asaj që kanë dëgjuar. Njëkohësisht e thellojnë pavarësinë dhe kompetencën sociale nëpërmjet asaj që, në mënyrë demokratike, i bisedojnë marrëveshjet dhe rregullat e qarta për përgjegjësitë, afatet etj. në lidhje me një projekt.

kl. 4–6

30–45 min.



Udhëzim:

Parakusht për këtë ushtrim është që N (ose një grup i tyre) të kenë kohë dhe një temë për një projekt. Këtu mund të bëhet fjalë për çështje të vogla (p.sh. përgatitja e pllakateve për aspektet e ndryshme të vendit të prejar-dhjes në grupe 3-she ose 4-she), ose për projekte të mesme (p.sh. Përgatitja e një referati për një temë nga historia ose gjeografia ose përgatitja për një recitim) ose për projekte të mëdha (koncepti për një libër ose një CD me tekste nga gjuha e prejar-dhjes; përgatitja e një feste ose e një mbremjeje me prindër me pjesë teatrale, koktej etj.). Është me rëndësi që të përcaktohet koha dhe kufizimet e përmbajtjes, ashtu që N të mund të punojnë mundësisht në mënyrë të pavarur.

Rrjedha:

- N e përcaktojnë qëllimin e projektit: «Çfarë duam të arrijmë bashkërisht?»
- N grumbullojnë ide: «Si mund t'i zbatojmë qëllimet tona në mënyrë optimale?»
- Idetë do të diskutohen në grupe ose me tërë klasën. Pyetjet ftilluese: «Cilat ide dhe qëllime mund t'i zbatojmë? Kush mund të drejtojë?»
- Në përfundim do të bëhet një plan me shkrim: «Kush bën, çka, si, kur, me kë?»

Vërejtje:

- Biseda për planifikimin, herën e parë do të udhëhiqet nga M. Pastaj udhëheqja e bisedës dhe rolet (p.sh. protokolluesi/ja) mund të merren përsipër nga N (krahajo këtu nr. 14. më lart). M vëzhgon dhe ndërhyr vetëm në raste të jashtëzakonshme.
- Pasi që rrjedha, nocionet kryesore (në gjuhën e parë!) dhe eventualisht pika të tjera të rëndësishme organizative të jenë shënuar në një letër, kjo i ndihmon N që të orientohen në bisedë dhe pastaj në punë.

Qëllimi

Të treguarit në rreth është një formë e thjeshtë, rituale e komunikimit shkollor: Zakonisht p.sh. në fillim të mësimit N ulen bashkërisht në rreth dhe i tregojnë njëri-tjetrit, se çfarë kanë përjetuar, që nga hera e fundit kur kanë treguar diçka. Kështu ata ushtrohen në të folurit e lirë, në aftësinë e të rrëfyerit kronologjik të një ngjarjeje dhe natyrisht edhe në të dëgjuar.

KP-kl. 9

15 min.




Rrjedha:

- M i thërret N (ose vetëm N të një niveli të caktuar) në fillim të mësimit të ulen në rreth. N e dinë formën e ritualizuar të të treguarit në rreth dhe e dinë se kanë vetëm për 15 minuta, për shembull, të tregojnë mbi përvojat e tyre gjatë javës së fundit. Edhe M flet se çfarë ka përjetuar dhe çfarë e preokupon atë.
- Rregullat e bisedës (shih më lart, nr. 9), të cilat tashmë janë trajtuar, natyrisht që do të zbatohen. Drejtimi mund edhe të merret përsipër nga një N, nëse kjo është ushtroar më parë (shih më lart nr. 14 dhe 15).
- Për shkollimin e të dëgjuarit, është vërtetuar rregulla e mëposhtme: N mund t'i shtrojnë dy pyetje fëmijës, që tregon. Atëherë fëmija tjetër tregon për përjetimet e tij.

Variantet:

- Të treguarit në rreth, natyrisht mund të ushtrohet edhe në fund të një njësie mësimore.
- Në rast të një ngjarjeje aktuale, e cila i shqetëson N, të treguarit në rreth mund të përdoret edhe për një diskutim përkatës dhe, nëse është nevoja, mund të zgjatet në aspektin kohor.



Vërejtje:

- Secili fëmijë vendos vetë se a do të marrë pjesë në bisedë apo jo. Gjithsesi M duhet të përkujdeset që, mundësisht, të gjithë N të marrin pjesë në bisedë.
- Fëmijët tregojnë të shumtën e herave me dëshirë dhe gjerësisht. M ose fëmija, i cili e udhëheq bisedën, duhet të përkujdeset që askush të mos tregojë tepër gjatë, në mënyrë që të gjithë N të kenë rastin ta marrin fjalën. Është i mundur një kufizim i kohës nëpërmjet orës së rërës. Nëse rëra ka rrjedhur nëpër orën e rërës (2 ose 3 min), kjo do të thotë që koha e të folurit të fëmijës është në përfundim.

Qëllimi

Ushtrimi i shërben zhvillimit dhe zgjerimit të repertorit argumentues dhe strategjive përkatëse. N duhet të përfaqësojnë një opinion në lidhje me një temë të caktuar, të kërkojnë argumentet e duhura dhe, ndoshta, të mendohen se si duan të reagojnë ndaj pozicioneve dhe argumenteve të kundërta.

kl. 4–9

20–40 min.



Rrjedha:

- Si pikënisje mund të shërbejë një deklaratë, pyetje, tezë ose mëtim, i cili duhet të ketë një potencial të mundshëm për diskutim. Kjo mund të vijë ose nga përvojat e N («Përse djemtë kanë më shumë liri se sa vajzat?», «Pse disa prindër janë kundër që kafshët të mbahen në shtëpi?»), apo ka të bëjë me një çështje aktuale politike («Çfarë mendoni për kërkesën për ta kufizuar numrin e të huajve») ose që ka të bëjë në lidhje me vendin e prejardhjes («Ku do të parapëlqenit të jetonit pas 20 vjetësh: këtu, ose në vendin e prindërve tuaj. Pse?»). Tema e diskutimit mund të propozohet nga M, ose edhe më mirë, nga N.
- Në varësi të temës, diskutimi do të përgatitet në dy ose tri grupe ose do të planifikohet që në fillim një debat për/kundër, në të cilin N do të përgatiten në dy grupe për argumentet e tyre. Është e rëndësishme që të gjithë N t'i shoshitin argumentet e tyre dhe mundësisht të mbajnë shënim nëpërmjet disa fjalëve kryesore.

Për

- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____

Kundër

- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____

- Është e mundshme, që të futet një raund i ndërmjetshëm, në të cilin do të përmbliidhen mjetet e të folurit dhe fillimet e fjalive në gjuhën e parë (dhe më vonë edhe të provohen!). Krahoso këtu edhe kreun 2c në hyrje dhe më lart numrat 10 dhe 12.
- Sigurisht që për diskutimin ose debatin vlejnë rregullat e bisedës (shih më lart nr. 9), ku në mënyrë të veçantë kërkohet një sjellje e ndershme dhe demokratike.
- Drejtimi dhe, ndoshta, edhe rolet e tjera mund të merren nga N, shih për këtë, numrat 14 dhe 15. Sidomos tek diskutimet për/kundër, është dëshmuar si e dobishme për të përcaktuar rolet e ndryshme udhëheqëse.
- Ndër detyrat më të rëndësishme të udhëheqësit të bisedës numërohet që të ketë vëmendje për të barazpeshuar përqindjet dhe pjesët për palët dhe pozicionet e ndryshme.
- Pas diskutimit duhet të ketë një raund të shkurtër të reflektimit dhe vlerësimit: Çfarë shkoi mirë; çfarë duhet të kemi edhe më shumë parasysh në raundin e ardhshëm?

Qëllimi

Një nga format veçanërisht të dendura dialoguese të bisedës numërohet edhe biseda mësimore mes M dhe N veç e veç. N mësojnë se si ata mund të përdorin gjuhën e tyre të parë në një kontekst të stërholluar pasqyruar. Ata mësojnë për të vlerësuar veten e tyre dhe pasqyrojnë të mësuarit e tyre, përparimet dhe pikat që ata ende mund t'i përmirësojnë.

kl. 1–9

5–25 min.



Udhëzime:

- Hapësirën për biseda mësimore në MGJP e formojnë kryesisht dy lloje situatash:
 - Biseda më të vogla mësimore në të cilat më shumë bëhet fjalë në lidhje me reagimet e shkurtra për një punë. Ky tip mund të bëhet gjatë orës, për shembull, krahas me punën në heshtje të N të tjerë.
 - Bisedat shumë të hollësishme mësimore në të cilat bëhet fjalë për një përcaktim më themelor. Ato kanë nevojë për më shumë kohë dhe duhet të kryhen para ose pas mësimi.
- Bisedat mësimore duhet të kryhen me secilin N, të paktën një herë gjatë një semestri. Në praktikë, kjo ndodh shpesh në raport me dëftesën. Po aq të vlefshme janë bisedat mësimore në lidhje me një detyrë të veçantë (prezantim etj).
- Është me rëndësi që M dhe N të përgatiten për bisedën. Për këtë qëllim N duhet të marrë pyetje ose detyra konkrete.
- Në raste të jashtëzakonshme, një bisedë mësimore mund të zhvillohet me dy N në të njëjtën kohë.
- Informacione të mira, nxitje dhe shembuj (në gjermanisht) mund të gjenden në internet në bazë të kërkimit në termin «Schulentwicklung – Lerngespräche führen» («Zhvillimi i shkollës – udhëheqja e bisedave mësimore»).

Rrjedha (Shembull):

- Si pikënisje mund të jetë kërkesa e M për të zhvilluar një bisedë mësimore për një punë të caktuar apo në përgjithësi mbi përparimet dhe nevojat për përkrahje të një N. Por, si pikënisje mund të jetë shqetësimi i një fëmije, për të biseduar me M për një detyrë të caktuar, në lidhje me problemet e tij, përparimet etj.
- Para bisedave më themelore duhet të përcaktohet një periudhë e përshtatshme dhe e mjaftueshme kohore, si dhe bashkëbiseduesit/et duhet të jenë të përgatitur.
- Biseda mësimore përfundon me një përmbledhje. Mënyrat e mundshme: Do të bëhet një protokoll i shkurtër me marrëveshjet e arritura ose do të përcaktohen objektivat konkrete për disa javë të ardhshme apo 3–4 muaj.

Shembuj të pyetjeve për përgatitje për bisedë mësimore për një punë të caktuar:

- Raporto të lutem: Çfarë kam arritur ta bëj mirë në këtë punë?
- Çfarë ishte e vështirë për mua?
- Ku kam nevojë për t'u përmirësuar?
- Çfarë mund dhe dua ta bëj ndryshe herën tjetër?

Qëllimi

«Të filozofuarit me fëmijët» në shumë shkolla të Evropës Perëndimore është një formë e dashur dhe e vlefshme për zhvillimin gjuhësor dhe atë të menduarit. Fëmijët i ndjekin çështjet, që u interesojnë dhe për të cilat nuk mund të gjenden përgjigje përfundimtare. Në aspektin gjuhësor ata e ushtrojnë kompetencën e të shprehurit me gojë, si dhe marrjen dhe reflektimin e informatave.

kl. 1–9

15–30 min.



Udhëzim për literaturën:
Krahaso vjegëza të ndryshme
në internet me fjalët kryesore
«Të filozofuarit me fëmijët».

Udhëzim:

- Temat mund të nxiten nga M, por nëse është e mundur ato duhet të dalin nga grupi i N. Këtu është me rëndësi që paraprakisht të bëhet një përmbledhje e ideve (Nxitje: «Mendohuni dhe shënoni tema apo pyetje, që ju prej shumë kohësh keni dashur t'i diskutoni me dëshirë ose çka dëshironi të dini më shumë. Mund të jenë edhe pyetje shumë të vështira»). Nga fondi i këtyre pyetjeve me klasën përzgjidhen pastaj disa prej tyre, të cilat do të shpërndahen e do të diskutohen gjatë muajve të ardhshëm.
- Temat që janë të përshtatshme për filozofim, mund të gjenden aty, ku edhe të rriturit nuk e kanë të gatshme përgjigjen e shpejtë. Shembuj: «Prej nga kam ardhur?», «Çfarë është një mik i mirë?», «Kush e shpiku gjuhën?», «Çfarë ndodh pas vdekjes?», «Pse ka racizëm?», «Çfarë do të thotë faktikisht, i/e huaj?»
- Hyrja mund të bëhet edhe me një foto, një tregim, një libër ose një gjësend.

Rrjedha:

- Këshillohet forma e të ulurit në rreth.
- Biseda filozofike mund të mbahet me tërë klasën ose me një ose dy grupe nivelesh, në qoftë se N e tjerë, me të vërtetë, punojnë në heshtje.
- Drejtimin mund ta bëjë M, por kjo gjithashtu mund të bëhet edhe nga N me përvojë, (për këtë arsye eventualisht edhe role të tjera, shih më sipër, nr. 14). Gjithsesi është e rëndësishme që M qëllimisht të qëndrojë në prapaskenë dhe të mos i kufizojë N.
- Është e rëndësishme që, para se të fillohet biseda, sërish të kujtohen rregullat më të rëndësishme të bisedës (shih më lart, nr. 9). Kjo përfshin në veçanti rregulla që askush të mos përqeshet dhe të merret seriozisht çdo ndihmesë, dhe gjithashtu rregullat se gjatë të filozofuarit nuk ka as përgjigje të drejtë, as përgjigje të gabuar. Kjo duhet t'u bëhet e qartë që në fillim të gjithë pjesëmarrësve/eve në bisedë.
- Tek të filozofuarit nuk qëndron në qendër përdorimi korrekt i gjuhës, por të shprehurit e lirë. Korrigjimet dhe ndërhyrjet duhet të shmangen nëse është e mundur.

Qëllimi

Pyetësorët dhe intervistat janë forma të mbledhjes së informacionit, të cilat janë me vlerë të lartë edhe në MGJP. Ato të çojnë në deklaratat autentike dhe «të dhënat», por cilësia e tyre është shumë e varur nga lloji i pyetësorit. Pra, e vlen patjetër që pyetjet të mendohen mirë. Në të njëjtën kohë këtu N mësojnë që, në një kontekst të ri, ta përdorin gjuhën e tyre të parë në mënyrë të diferencuar dhe të reflektuar.

kl. 3–9

30–90 min.



Materiali:
Eventualisht shembull të
një pyetësori/interviste.

Udhëzim:

- Si pyetësor, ne u referohemi këtu pyetësorëve në të cilët nga pyetjet e formuluar shkurt, p.sh regjistrohen dhe numërohen përgjigjet e 20 personave (p.sh. përdorimi i televizorit apo vendpushimet). Përkundrazi, në intervistë shtrohen pyetje më të hapura, të cilat çojnë tek përgjigjet dhe raportet e gjata. Intervistat bëhen, edhe për shkak të vlerësimit i cili merr shumë kohë, zakonisht me vetëm një ose disa persona.
- Përmbajtja e intervistës apo anketa duhet të jetë e dhënë. Zakonisht ajo rezulton nga një tematikë, që qëndron në qendër, në mësim ose diku tjetër dhe për të cilën pyeten njerëzit nga kultura e tyre në cilësinë e ekspertëve/eve. Shembuj: Intervista me prindërit tanë dhe gjyshërit rreth temës «Koha e lirë, në të kaluarën dhe në të tashmen» ose «Fëmijëria, në të kaluarën dhe në të tashmen». – Biseda telefonike me shokun/dhe të afërmit për «Veprimtaritë e kohës së lirë këtu dhe në vendin e prejardhjes». – Intervistat me njerëz të ndryshëm mbi «Të drejtat dhe rolet e vajzave dhe djemve».
- Mundësi të reja, të cilat patjetër duhet të përdoren janë intervistat dhe pyetësorët me anë të telefonit ose Skype; për pyetësorët me shkrim edhe me e-mail, SMS, Facebook etj. Me këto media lehtë mund të pyeten njerëzit edhe në vendin e prejardhjes, mundësi këto, që nuk duhet humbur.

Rrjedha:

- Para se të zhvillohen intervistat dhe pyetësorët duhet të bëhet një hyrje në temën dhe në «metodikën» e tyre. Këtu M në MGJP mund të lidhet me siguri me përvojat nga mësimi i rregullt (kjo duhet të zgjidhet nëpërmjet asaj që të pyeten N ose M e mësimi të rregullt).
- Hyrje e mundshme: M e bën një ushtrim praktik nëpërmjet asaj që një N e pyet për një temë nga përditshmëria dhe eventualisht në mënyrë të qëllimshme shtron pyetje të mira dhe më pak të përshtatshme. Kjo mund të bëhet, gjithashtu, me një pajisje regjistrimi, për shembull, me telefon celular, kështu që ju më vonë mund të dëgjoni përsëri pyetjet dhe përgjigjet.
- Pastaj kjo përvojë do të pasqyrohet dhe do të përdoret si një mundësi për të gjetur kriteret për një pyetësor të mirë apo një intervistë të mirë. Këto kriteret duhet t'i marrin parasysh N në pyetësorët ose intervistat e tyre.
- Si hapa në konceptimin e një pyetësori do të përpunohen me sa vijon (për intervistë, shih më poshtë):

Hapat tek konceptimi i një pyetëso

- ▶ Të përcaktohen objektivat e pyetësorit (çfarë duam të dimë?).
- ▶ Të gjenden pyetje të përshtatshme. Këtu mund të dallohen dy tipe të pyetjeve:
 - *Pyetje të vendosura*: Këtu mundësitë e përgjigjeve janë të paradhëna (dhe nëpërmjet kësaj edhe më lehtë për t'u dokumentuar dhe vlerësuar). Shembull: «A flisni më me dëshirë anglisht apo gjermanisht?». Ky lloj i pyetjeve është karakteristik për pyetësorët.
 - *Pyetje të hapura*: Këtu është e mundur të jepen më shumë se një përgjigje ose përgjigje më të gjata. Kjo çon në një gamë të gjerë të spektrit të të dhënave, por është më e kërkuar për vlerësimin. Shembull: «Çfarë duhet të mësojmë ne në shkollë sipas mendimit tuaj?». Ky lloj i pyetjeve përdoret më shumë tek intervistat.



- ▶ Tashmë duhet menduar se si të vlerësohen përgjigjet (numërimi, përmbledhja, komentimi etj). Këtu M duhet patjetër të këshillohet.
- ▶ Edhe natyra e prezantimit final tashmë duhet të mendohet dhe të rregullohet në mënyrë të qartë.
- ▶ Të përcaktohet se si dhe ku të regjistrohen pyetjet dhe përgjigjet (regjistrimi me magnetofon ose telefon celular, përmbledhje me shkrim). Nëse pyetësoi bëhet nga dy veta, N 1 mund t'i shtrojë pyetjet dhe N 2 i përmbledh gjegjësisht i dokumenton ato.
- ▶ Të gjendet një vend i përshtatshëm për pyetësorin (të mos ketë pengesa, të mos ketë zhurmë).
- ▶ Të gjenden njerëz të përshtatshëm, duke i informuar ata për kontekstin e pyetësorit dhe për t'i lutur që të marrin pjesë.
- ▶ Të bëhet një test provues me 2–3 njerëz dhe eventualisht të përshtaten pyetjet.
- ▶ Pyetësoi të zhvillohet me persona të tjerë; të falënderohet secili.
- ▶ Pyetësoi të vlerësohet me shkrim: Sa njerëz i janë përgjigjur dhe çfarë? Çfarë kemi mësuar (përgjigjet të përmbledhen për secilën pyetje)? Çfarë kemi mësuar diçka të re? Çfarë ishte emocionuese apo e vështirë?
- ▶ Prezantimi i rezultateve në përputhje me përcaktimet e diskutuara më parë (p.sh. 10 minuta si një referat i shkurtër ose një poster).

**Pikat shtesë për
intervistë (më kërkuese
se pyetësi):**

- Këtu pyetjet duhet të formulohen në mënyrë të hapur dhe të gjerë, në mënyrë që intervistuesin ta sillni në situatë për të treguar. Në mënyrë që biseda intervistuese të fillojë, nuk shtrohen pyetje, të cilat mund të përgjigjen me vetëm një fjalë. Përkundrazi, shumë më tepër janë të përshtashme të shtrohen pyetjet me si, çfarë, pse, ku, dhe kur, si dhe për të pyetur edhe më tutje nëse diçka tingëllon interesante.
- Përgjigjet gjatë intervistës do të shënohen me fjalë kryesore ose do të regjistrohen. Tek intervistat e gjata një tekstualizim fjalë për fjalë është shumë i kushtueshëm. Në vend të tekstualizimit, gjatë prezantimit përfundimtar mund të paraqiten pjesë të zgjedhura të regjistrimit.

Pjesa III:
Të treguarit dhe të luajturit e
përjetimeve dhe të tregimeve

Qëllimi

N mësojnë të njohin strategjitë dhe këshillat konkrete, me të cilat ata e përgatitin dhe e përmirësojnë të treguarit gojor. Ushtrimi (i cili natyrisht duhet të përsëritet shumë herë) përkrah kompetencën në të shprehur në gjuhën e parë dhe ndihmon për zgjerimin e leksikut dhe repertorit sintaksor.

kl. 2–6

20–45 min.




Rrjedha:

- M u rrëfen N një tregim të shkurtër. Ai/ajo do të ketë kujdes që këshillat për të treguar (shih më poshtë) t'i zbatojë mirë dhe t'i theksojë. (Varianti: M e tregon mërzitshëm dhe në mënyrë monotone tregimin në fillim e pastaj në mënyrë të gjallë dhe shprehëse.)
- N dëgjojnë me vëmendje. Në bisedën e mëvonshme do të diskutohet, se si duhet të tregohet diçka në mënyrë që për dëgjuesit të tingëllojë e gjallë dhe interesante. Këtu duhet që pikat veç e veç të provohen drejt-përdrejt edhe në mënyrë praktike.
- Së bashku, pikat do të përmbledhen në formë të një liste «Këshilla për të treguarit e gjallë», dhe do të shënohen me shkrim (shih shembujt më poshtë).
- Për zbatimin praktik (eventualisht në një mësim të mëvonshëm) çdo fëmijë e mendon një episod apo një ngjarje që dëshiron ta paraqesë në përputhje me këshillat (varianti: grupe dyshe, kjo mundëson dialogun). Krahaso për këtë gjithashtu më poshtë nr. 23 (Tregime të përditshmërisë), 24 (Tregime personale) dhe 25 (Të treguarit modelues).
- Është e dobishme që, si parapërgatitje e shkurtër me shkrim, të shënohen shkurtimisht fjalët kryesore për pikat e rëndësishme të tregimit. Kush dëshiron, mund edhe të shkruajë tërë tregimin dhe këtë tekst pastaj ta marrë si bazë për ushtrimet e mëvonshme.
- Me ndihmën e M do të sqarohen çështjet gjuhësore dhe problemet. Ndoshta M mund të ndihmojë gjithashtu me shembujt të mirë për fillime të ndryshme të fjalive etj.
- Tani fillojnë N të ushtrojnë të treguarit. Për këtë zgjedhin dy ose tri këshilla, të cilat do të kenë kujdes t'i kushtojnë vëmendje të veçantë.
- Nëse secili fëmijë e ka ushtruar dy-tri herë të treguarit për vete, e kërkon një partner dhe ia rrëfen atij tregimin. Feedback-u ndihmon që prezantimi të përmirësohet edhe më tutje.
- Prezantimi përfundimtar do të zhvillohet ose para tërë klasës ose brenda grupit të nivelit. N e tjerë dëgjojnë me kujdes dhe pastaj shprehin në vazhdim mendimet e tyre të orientuara sipas kriterëve, të cilat lidhen me zbatimin e këshillave të të treguarit.
- Në diskutim duhet patjetër të përfshihen edhe aspektet gjuhësore: Çfarë ishte e vështirë në gjuhën e parë; çfarë (dhe si), ne ende duhet të mësojmë në këtë drejtim?

Udhëzime:

- Ushtrimi mund të jetë shumë sfidues për N e ndrydhur dhe për ata me aftësi të pakta në gjuhën e parë. Në raste të tilla, arsimtari apo një fëmijë më i rritur me aftësi të mira gjuhësore duhet domosdoshmërisht të japin mbështetje. Ushtrimet e tipit të përmendur, megjithatë, janë shumë të dobishme pikërisht për N e dobët. Prandaj, duhet të shmangen me çdo kusht përjetimet dështuese.
- Motivimi shtesë për të treguarit e mirë mund të lindë nga fakti se bëhet marrëveshje me klasën apo me grupin e nivelit që t'i regjistrojnë tregimet dhe t'i vënë ato në shfrytëzim si CD ose MP3. Nëse për këtë zgjedhet një temë e përbashkët e të treguarit (p.sh. Aventurat e pushimeve nga vendi i prejardhjes), atëherë nëpërmjet kësaj rezulton përmbledhja (e regjistruar) tematike koherente dhe tërheqëse.
- Krahaso gjithashtu, nr. 10 («Përgatitja për një bisedë»), ku ndiqen qëllime të ngjashme në lidhje me situatat dialoguese të komunikimit, si dhe nr. 25 (Të treguarit e modeluar), 29 (Të ushtrohet të lexuarit para të tjerëve) dhe 30 (Një referat të përgatitet).



Këshilla për të të treguarit

- Fol me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë, në mënyrë që të të kuptojnë të gjithë!
- Përdore zërin tënd në mënyrë të ndërgjegjshme: me zë të lartë dhe të butë, kërcënues, miqësor, të trishtuar, të lumtur ...
- Shfrytëzoji edhe shprehjen e fytyrës sate dhe lëvizjet: bëje një fytyrë të keqe, të lodhur, fytyrë të lumtur; lëvize trupin tënd në përshtatshmëri me veprimin.
- Lëshoji sytë në mënyrë të vazhdueshme nga publiku; ndonjëherë drejtoja edhe publikut ndonjë pyetje.
- Përshkruaji njerëzit dhe kafshët, që paraqiten në tregimin tënd, saktësisht dhe gjallërisht. Si duken ata, çfarë lloj përshtypjeje lënë ata?
- Përshkruaji edhe vendet, që shfaqen në tregim tënd, saktësisht dhe gjallërisht. Çfarë mund të shihet aty, të dëgjohet dhe të nuhatet, si është atmosfera?

Qëllimi

Tek tregimet e përditshmërisë bëhet fjalë më së shumti për t'i treguar përjetimet ose përvojat e përditshmërisë personale. Ky lloj i thjeshtë dhe i nivelit të ulët të të treguarit nuk ka kërkesa të larta për imagjinatën, por edhe ky ndihmon në zhvillimin e aftësive në të folur, në strukturën e tekstit dhe në të dëgjuar.

KP-kl. 9

10–30 min.



Rrjedha (përzgjedhje e mundësive):

- Nëse nuk zgjidhet si mënyrë e të treguarit e «ritualizuar» në rreth (shih më lart nr. 17), fillimi për tregimet e përditshmërisë jetësore gjithashtu mund të bëhet nga M me një hyrje në këtë temë. Kështu, për shembull, M tregon një ilustrim ose edhe mund të fillojë vetë me një episod; pastaj, në vazhdim flasin fëmijët. Në mënyrë që N të dëgjojnë me kujdes njëri-tjetrit dhe që ndihmesat të mos i ndjekin pa përfshirje, duhet që N t'i shtrojnë pyetje njëri-tjetrit dhe t'i referohen njëri-tjetrit. (krahajo për këtë më sipër, nr. 12).
- Variante: M ose një fëmijë sjell një objekt me vete dhe tregon diçka. Ky mund të jetë, për shembull, një send i dashur, diçka nga vendi i prejar-dhjes ose një send të cilin e përdor çdo ditë. Më së miri është që para-prakisht të jepet një detyrë përkatëse për këtë («Sillni javën e ardhshme këtë... !»).
- Si një hyrje mund të raportojë edhe një fëmijë për një përjetim të rëndësishëm dhe kështu t'i nxitë N e tjerë për të treguar për përjetime të ngjashme.
- Edhe një ngjarje e ardhshme nga jeta shkollore apo një festë fetare apo ndonjë tjetër mund të përdoret si një hyrje për tregime të përditshmërisë.

Vërejtje:

- Tregimet e përditshmërisë janë një formë joformale e thjeshtë. Megjithatë, edhe këtu mund dhe duhet të merret parasysh një formë përkatëse e prezantimit (shih. Këshilla për të treguarit në nr. 22).
- Diskutimet e këtij lloji jo gjithmonë ndodhin me tërë klasën. Janë të përshtatshme, për t'i lënë fëmijët të tregojnë nga jeta e tyre e përditshme, gjithashtu koha para se të fillojë mësimi ose pushimet e shkurtra.

Qëllimi

Tek tregimet personale në kontekstin shkollor të moderuar N mësojnë për ta përdorur gjuhën e tyre të parë edhe në paraqitjen e përvojave të tyre dhe për të shprehur ndjenjat e tyre. Ata, gjithashtu, thellojnë aftësitë e dukshme komunikuese, siç janë të dëgjuarit me kujdes, të pyeturit e vijueshëm, referimet e ndërsjella. Dhe, në fund tek të treguarit personal përkrahen aspekte të tilla të rëndësishme sociale si ndjeshmëria dhe mirë-kuptimi i ndërsjellë.

kl. 2–9

10–30 min.



Materiali:
Eventualisht letrat e bisedës
(shih më poshtë).

Udhëzime:

- Me të treguarit spontan e të padrejtuar të përjetimeve personale, të përvojave etj., nuk do të merremi këtu, sepse edhe ashtu këto duhet ta kenë vendin e tyre në shkollë. Kjo mund të bëhet në situata të planifikuara, të tilla si p.sh., në të treguarit në rreth (shih më lart nr. 17), ose edhe krejt e paplanifikuar, kur duam ta tematizojmë një problem, një përvojë të rëndësishme apo një ngjarje të lumtur.
- Sigurisht, asnjë fëmijë nuk duhet të detyrohet të zbulojë ndjenjat personale, përjetimet apo përvojat e veta. Natyrës së rrëfimit personal i përket vetëdëshira, si një karakteristikë e rëndësishme. Por, megjithatë, nëse një fëmijë, gjithmonë rri i heshtur për një kohë të gjatë, M duhet të mendohet në lidhje me shkaqet për një situatë të tillë dhe të mundohet të bëjë përmirësimin e kësaj gjendjeje.

Rrjedha:

- Për fillim si nxitje për situatat e bisedës në të cilat bëhet fjalë për mendime, përvoja dhe ndjenja personale, M mund të shkruajë në dërrasë të zezë një pyetje, e cila pastaj do të diskutohet. Shembuj për nxitje të tilla:



- Gjithashtu mund të shërbejë shumë mirë edhe ndonjë propozim nga N si nxitje fillimi.
- Gjithashtu, edhe ilustrimet ose fotografitë mund të jenë një shtysë e mirë për bisedat personale.
- Një ide e mirë është, që në një zarf (ndoshta anonim) të mblidhen sugjerimet për raundet e bisedave personale.

- Në të vërtetë para diskutimit N duhet të kenë kohë disa minuta në mënyrë që të shënojnë mendimet dhe reagimet e tyre, si dhe ndonjë problem eventual gjuhësor. Krahaso për këtë më sipër, nr. 10 (Të përgatitesh për një bisedë).
- Ndoshta para bisedës është i nevojshëm një raund i shkurtër, që të qartësohet në çështjet e
 1. e sqarimeve të pyetjeve gjuhësore (nacionet në gjuhën e parë),
 2. M mund t'i propozojë këtu disa pjesë të fjalive ose mjete të të shprehurit, të cilat do të ishin këtu shumë të dobishme (Faza të tilla si «Sipas mendimit tim... », «Unë mendoj më tepër që ... ») dhe
 3. duhet edhe njëherë të kujtohen për rregullat e rëndësishme si p.sh. «Unë dëgjoj me vëmendje», «Askush nuk përqeshet për shkak të mendimit të tij», «Unë nuk e ndërpres askënd», etj (krahaso më lart nr. 9).
- Diskutimi i çështjes së pari mund të kryhet në grupe dyshe ose edhe në grupe më të mëdha (grupe nivelesh ose tërë klasa).

25 Tregimet e modeluara

Qëllimi

Tek të treguarit modelues një rol veçanërisht të rëndësishëm luajnë gjuha dhe përdorimi i gjeesteve dhe i mimikës. N mendojnë këtu që të përdorin gjuhën e tyre të parë në një formë më të lartë dhe shprehëse, e cila shkon përtej përdorimit të përditshëm. Të treguarit modelues zë kështu një pozicion të ndërmjetëm midis të folurit të thjeshtë dhe formave të vogla dramatike (krahaso për këtë, nr. 26–28).

kl. 3–9


20–40 min.



Materiali:
Eventualisht tekste për t'i zgjedhur për N (përralla, fabula, rrëfime ...).

Rrjedha:

- Hyrje e mundshme: M tregon një ngjarje, p.sh. një përrallë, një baladë ose një tregim (jo aq të gjatë) nga kultura dhe letërsia e tij. M mundohet për një prezantim mundësisht sa më shprehës e të gjallë dhe i merr parasysht këshillat e të treguarit nga nr. 22.
- Kështu pastaj M u thotë N që ata vetë, personalisht ose në grupe të vogla, të ushtrojnë që ta prezantojnë një tregim të një forme të tillë. Ai/ Ajo vë në shfrytëzim tekste përkatëse (tekste të shkurtra për N të dobët, tekste të gjata për më të mirët).
- Edhe një herë do të përmbledhen kriteret e rëndësishme për të treguarit e gjallë dhe shprehës (krahaso këshillat te nr. 22); të cilat N duhet t'i kenë parasysht.
- N ushtrojnë për ta prezantuar tregimin e tyre (për rrjedhën krahaso më lart nr. 22).
- Para tërë klasës do të prezantohen tregimet veç e veç.
- Në përfundim vijon një bisedë e orientuar sipas kriterëve, krahaso nr. 22.



Variantet:

- M tregon si nxitje për një hyrje një fotografi ose një gjësend. Pastaj tërë klasa e sajón një tregim për këtë, nëpërmjet asaj që një fëmijë fillon të

rrëfejë tregimin, tjetri e rrëfen më tutje tregimin dhe kështu më tutje. Tregimi përmbyllet kur të gjithë fëmijët kanë kontribuar me pjesën e tyre. Tregimet duhet të modelohen sa i përket zotërimit të zërit, gjesteve dhe mimikës mundësisht në formë sa më shprehëse. Ky variant është i përshtatshëm, para së gjithash, për grupet e vogla.

- M i shpërndan skedat me fjalë për fushën e një teme. Ai/Ajo e rrëfen fillimin e një tregimi, nëpërmjet asaj që e formon një fjali, ku përdoret fjala, që është në skedën e tyre. Një fëmijë vazhdon më tutje, nëpërmjet asaj që e formon një fjali, ku përdoret fjala e leksikut të skedave; etj.
- Motivim plotësues ndodh kur tekste të treguarit regjistrohen dhe p.sh. në një CD ose si MP3- mund të jenë në shfrytëzim.

26

Lojëra pothuajse reale, lojëra rolesh sociale

Qëllimi

Në dallim nga lojërat e thjeshta të roleve, në nr. 8 bëhet fjalë për për tipin vijues të paraqitjeve të modeluara me përcaktime të hollësishme. Këtu ushtrohen aftësitë në të argumentuar, përdorimi i qëllimshëm dhe i modeluar i gjuhës dhe mjeteve jo-verbale (gjestet, shprehjet e fytyrës) dhe aftësia për të prezantuar bindshëm vetëveten. Varësisht nga tema, skenat ndihmojnë edhe në zhvillimin e strategjive të të folurit dhe fjalorit për tema të veçanta.

kl. 3–9

30–45 min.



Materiali:
Eventualisht disa rekuizita.

Rrjedha:

- M e përshkruan një situatë që ka një konflikt, diskutim ose tension potencial të caktuar. Shembuj:
 - a) Në shkollë dy N grinden mes tyre, sepse njëri ia ka thyer pa dashje lapsin një tjetri.
 - b) Në kohën e lirë dy fëmijë vendas ose adoleshentë tallen me dy të ardhur.
 - c) Gjatë pushimeve në vendin e prejardhjes: dy të rinj që jetojnë atje, e trajtojnë në mënyrë qesharake një të ri, i cili i kalon pushimet atje.
 - d) Gjatë darkës në shtëpi: fëmija dëshiron diçka, që prindërit kurrësi nuk e lejojnë (p.sh. një qen ose dëshiron të shkojë në disko).
- Diskutim në grup apo me tërë klasën se si N do të reagonin në këtë situatë. Pyetje të mundshme dhe shtysa: Si do të ndiheshe ti në këtë situatë? Çfarë mendimesh do të kishe ti? Si do të silleshe ti konkretisht? Çfarë zgjidhjesh realiste janë të mundshme?
- Eventualisht një raund për mjetet gjuhësore, shih më poshtë tek «Vërejtje».
- Diskutimi i shkurtër, cilave kritere duhet t'u kushtohet vëmendje tek paraqitjet individuale (p.sh. arsyeshmëria e zgjidhjeve, cilësia e gjuhës, kuptueshmëria, etj). Kriteret duhet të jenë transparente dhe të jenë të njohura për të gjithë N. Për të punuar me tabelën e kriterëve, e cila është e përshtatshme për këtë, krahaso kap. 4c në hyrje.
- N ndahen në grupe (ose formojnë grupe të pavarura). Ata kanë kohë 10–15 min për të përgatitur paraqitjen e tyre. Kjo duhet të marrë jo më shumë se 5–8 minuta kohë.

- Grupet i luajnë zgjidhjet e tyre para të tjerëve. Pas secilës paraqitje (ose pak grupe: në fund) pason një feedback i orientuar në kritere nga ana e N të tjerë.

Variantet:

- Si hyrje dhe paracaktim i lojës në vend të një rrëfimi mund të shërbejë edhe një fotografi, e cila paraqet një situatë të tensionuar.
- Situata të tilla për një hyrje natyrisht mund të nxiten edhe nga N.

Vërejtje:

- Varësisht nga tema mund të jetë e dobishme që në përfundim të diskutimit të një përmbajtjeje, të bëhet një raund për mjetet gjuhësore, të cilat janë përdorur për skenat përkatëse. Këtu mund të bëhet fjalë për leksikun e veçantë sipas temës ose edhe të flitet për mjetet e përgjithshme të të shprehurit me gojë, të cilat janë të dobishme gjatë të argumentuarit. Krahajo këtu kreun 2c në hyrje.
- Paracaktimet e lojës, tek të cilat bëhet fjalë për një zgjidhje të një konflikti, e përkrahin në masë të veçantë kompetencën sociale; krahajo këtu numrat 1.5, 2.6, 4.7, 5.2, 5.5, 5.7 dhe 6.7. të broshurës «Kompetencat ndërkulturore».

27

Lojëra fiktive, dramatizimi i teksteve

Qëllimi

Dramatizimi i skenave nga një tekst e përkrah të kuptuarit e tekstit, ndihmon në shtendosjen e sekuencave të të lexuarit dhe nxit ndërtimin dhe zgjerimin e repertorit sintaksor të N. Për këtë arsye, dramatizim i sekuencave të teksteve në MGJP, është një mjet shumë i vlefshëm pikërisht sa i përket të mësuarit të gjuhës standarde. Për qëllimet në fushat e tjera krahajo numrat 8, 26 dhe 28.

kl. 2–9

20–30 min.



Materiali:
Eventualisht rekuizita.

Rrjedha:

- Si pikënisje mund të jetë një dramatizim i një teksti të përshtatshëm ose një tregim, i cili lexohet ose nga N ose M e lexon ose e rrëfen para nxënësve. Këtu mund të përdoret edhe ndonjë libër i ilustruar.
- Pas një skene të përshtatshme (në të cilën paraqiten mundësisht më shumë persona), ose tek një moment veçanërisht interesant i tregimit, M e ndërpret të lexuarit ose të lexuarit para të tjerëve. Ai/a jo bën thirrje që N, skenën e lexuar ta luajnë në grupe të vogla ose ta mendojnë një zgjidhje për vazhdimin e tregimit dhe pastaj ta inskenojnë atë.
- Do të formulohen paracaktime të qarta: Koha për parapërgatitje 5–10 min, paraqitja më së shumti prej 5 minuta. Gjithashtu do të përcaktohen kriteret, që do të vlejné për vlerësimin përfundimtar (shih më lart te nr. 26; mirë do të ishte që edhe këtu gjithashtu të jenë rastër kriteresh të cilat do t'i kenë parasysh edhe kriteret gjuhësore).
- N do të ndahen në grupe ose formojnë vetë grupe të pavarura. Ata kanë kohë 5–10 min., për t'u përgatitur për paraqitjen e tyre. Kjo duhet të marrë jo më shumë se 5 minuta kohë.
- Grupet i luajnë zgjidhjet e tyre para të tjerëve. Pas secilit prezantim (ose nëse janë pak grupe: në fund) pason një feedback me kritere të orientuara nga ana e N të tjerë.

Variantet:

- Në varësi të tekstit mund të caktohet për çdo grup një skenë e vetme nga tregimi. Në përfundim skenat do të ndërlidhen së bashku dhe do të prezantohet pastaj si pjesë e përbashkët teatrore. Së fundi, skenat janë të lidhura së bashku dhe kryhet si një lojë të vazhdueshme.
- Për lojën imagjinare ose dramatizimin e teksteve janë të përshtatshme gjithashtu edhe kukullat- gishta ose lojërat- hije në projektor.

Vërejtje:

- Për t'ia dhënë N leksikon e nevojshëm, mund të shënohen në dërrasë të zezë mjete të rëndësishme të të folurit dhe të diskutohen para dhënies së detyrës; krahaso për këtë udhëzimet te nr. 26.
- Në varësi të tekstit, afër aktorëve/eve duhet që të caktohet edhe një fëmijë si tregimtar/e.
- Aktorët/et flasin para një publiku të madh. Për këtë arsye, N duhet tu bëhet e qartë në këtë ushtrim se sa e rëndësishme është që të kenë shqiptim të qartë. Ky është sigurisht njëri nga kriteret, të cilëve u kushtojnë vëmendje fëmijët shikues gjatë lojës.

28 Lojëra teatrore shkollore

Qëllimi

Nëpërmjet lojës teatrore shkollore forcohen kompetencat e paraqitjes personale, prezantimi i lirë, raporti me gjestet, mimika dhe gjuha krijuese dhe e pastër si dhe zgjerohet repertori leksikor dhe sintaksor në gjuhën e parë. Kompetencat e fituara në forma të thjeshta (krahaso nr. 8 dhe 27) do të përmbledhen këtu dhe i shërbejnë, në korniza motivuese, vënies në skenë të pjesëve më të mëdha.

kl. 3–9


180 min.



Materiale:
Rekuizitat.

Rrjedha:

- Së bashku me N do të shkruhet ose një skenar për pjesë teatrore ose një tregim ekzistues do të rishkruhet dhe dialogohet (të dy variantet janë njëkohësisht edhe projekte jashtëzakonisht të dobishme në të shkruar). Është gjithashtu e mundshme që të merret një tekst i gatshëm dhe të vëhet në skenë.
- Pastaj skenat e veçanta do të ushtrohen. Do të bëhen ushtrime për shqiptimin dhe do të diskutohet dhe provohet përdorimi i gjuhës së trupit, shprehjeve të fytyrës dhe gjeesteve.
- Do të organizohen rekuizitat do të planifikohet prezantimi përfundimtar (hapësira, programi, ftesat, aperitiv etj).



- Skenat do të studiohen njëra pas tjetrës, në mënyrë që N të fitojnë besim dhe M të mund të tërhiqet në prapaskenë gjithnjë e më shumë.
- Në aspektin e proceseve të të mësuarit është e rëndësishme që N t'i japin vazhdimisht feedback njëri-tjetrit. Për këtë qëllim do të vendosen paraprakisht kriteret dhe pikat e vëzhgimit.
- Skenat do të bashkohen gradualisht, ashtu që në fund pjesa teatrale të jetë e përfunduar.
- Vënia në skenë duhet të mbahet brenda një kuadri të përshtatshëm, p.sh. në kontekstin e një mbrëmjeje me prindër me ftesa, fletën e programit dhe aperitiv.

Vërejtje:

- Është e mundshme që grupet e moshave të ndryshme në MGJP të ushtrojnë nga një pjesë, ashtu që në mbrëmjen përfundimtare të paraqiten p.sh., tri pjesë të vogla ose skeçe.
- Në mënyrë që N të mësohen me lojën teatrale, është e rëndësishme që të fillohet së pari me pjesë të vogla teatrale dhe pastaj kërkesat të rriten në mënyrë të vazhdueshme.

Pjesa IV: **Të prezantuarit dhe të referuarit**

Qëllimi

Tek leximi shprehës para të tjerëve dhe tek recitimi (të shumtën për-mendësh) trajnohet, si tek të treguarit e modeluar (nr. 25), në mënyrë të qëllimshme marrëdhënia me gjuhën e folur. Këtu bëhet edhe zgjerimi i leksikut, njohja e mundësive të zgjeruara sintaksore dhe aspekteve të fushës letrare.

kl. 2-9

10-20 min.



Materiali:
Tekste të përshtatshme sa i përket gjatësisë dhe moshës.

Udhëzim:

- Propozimi është i përshtatshëm për MGJP, ngase këtu grupet e ndryshme, sipas nivelit dhe moshës, mund të ushtrojnë tekste të ndryshme. Në këtë mënyrë të gjitha grupet punojnë në të njëjtin qëllim, por me nivele kërkesash të ndryshme.
- Lidhje të ngushta tek të të lexuarit para të tjerëve krijohen me broshurën «Përkrahja e të lexuarit në gjuhën e parë» krahaso atje para së gjithash numrat 1 dhe 10.

Rrjedha:

- M do t'i informojë N për qëllimin: bëhet fjalë për të lexuar sa më bukur para të tjerëve ose për të recituar një poezi në mënyrë sa më shprehëse. Në fund duhet që të gjithë N të paraqesin tekstin e tyre; ndoshta në kuadër të një feste dhe eventualisht me një incizim toni.
- Çfarë do të thotë vallë «të lexosh bukur para të tjerëve»? Këtu mund të merret procedura e paraqitur tek nr. 22 (shembull i mirë/i keq, të formulohen kriteret në bazë të vështirimeve). «Këshillat e të treguarit» tek nr. 22 mund të modifikohen mirë si këshilla për të lexuarit para të tjerëve dhe për të recituarit (shih listën më poshtë).
- M u shpërndan N tekste të përshtatshme e të shkurtra. Nëse ushtrimi bëhet me grupet e niveleve të ndryshme, duhet që të jetë të paktën një tekst në dispozicion për secilin grup. Është gjithashtu e mundshme që dy N të marrin një tekst; nëpërmjet kësaj shumëllojshmërie të lexuarit përfundimtar para të tjerëve do të jetë më interesant.
- N e lexojnë tekstin në heshtje për vete. Ata i nënvizojnë fjalët e paqarta dhe frazat si dhe fjalët që janë të vështira për t'i shqiptuar. Pastaj diskutohen paqartësitë. Ndoshta një informacion në lidhje me autorin apo poetin.
- N i zgjedhin tri kriteret të leximit, të cilave ata duan t'i kushtojnë vëmendje të veçantë.
- N e lexojnë tekstin me zë të lartë në tri ditët e tri javëve të njëpasnjëshme.
- N gjithashtu ushtrojnë në çifte apo grupe të vogla dhe i japin njëri-tjetrit reagimet e tyre (Pyetjet: «Çfarë ishte mirë gjatë të lexuarit para të tjerëve?», «Çfarë mund të përmirësosh ende?»).
- Në përfundim, në grup të madh, do të lexohet para të tjerëve ose do të recitohet, kjo ndoshta edhe si pjesë e një takimi me prindër apo feste. Në mënyrë plotësuese eventualisht edhe si incizim (CD, MP3).

Variantet:

- N mund të përzgjedhin një tekst të vetin. Për ata N të cilët nuk kanë tekste në shtëpi, duhet që M të sjell libra me tekste për t'i zgjedhur.
- Fëmijët mund ta incizojnë vetëveten gjatë të lexuarit para të tjerëve dhe pastaj ta dëgjojnë incizimin. Kjo ua thjeshtëzon atyre që ta përceptojnë shqiptimin e tyre dhe rrjedhshmërinë në të lexuar dhe edhe t'i përmirësojnë ato.



Këshila për të lexuarit para të tjerëve dhe për të recituarit

- Fol me zë të lartë dhe qartë, në mënyrë që të kuptojnë të gjithë!
- Mos lexo tepër shpejt, por as tepër ngadalë. Bëj pauza.
- Ke kujdes shenjat e pikësimit në fjali, theksoji fjalitë në mënyrë përkatëse!
- Përdore zërin tënd në mënyrë të qëllimshme: zë të lartë e të ulët; kërcënues, shoqëror, pikëllues, të gëzueshëm ...
- Përdori edhe mimikën dhe gjestet: bëje një pamje të fytyrës të egër, të lodhur, të gëzuar; lëvize trupin në mënyrë të përshtatshme me veprimin.
- Mos u fsheh prapa tekstit tënd; lëshoji sytë vazhdimisht nga publiku yt.

Qëllimi

Kur mbajnë referate të vogla, N mësojnë t'i bashkërendojnë aspektet përmbajtësore, gjuhësore dhe modeluese. Propozimi mësimor tregon se si N përgatiten para së gjithash në performancën gjuhësore dhe si mund ta bëjnë më mirë atë me anë të një liste këshillash.

kl. 3–9

30–45 min.



Udhëzim:


- Në mësimin e rregullt, referate të vogla ushtrohen tashmë që në klasat e ulëta; edhe në MGJP ato janë të mundura dhe të këshillueshme nga klasa e 3/4, nëse N mbështeten në mënyrë përkatëse.
- Për këtë krahaso edhe temën «Përgatitja e një referati» te numri 31 dhe materialin e nxënësve tek M14 në broshurën «Dhënia e strategjive dhe teknikave mësimore në MGJP» (= Broshura 5 e kësaj serie). Ky material i është kushtuar temës «Një referat të përgatitet dhe të mbahet», dhe merret gjithashtu me aspektet e lidhura me përmbajtjen (mbledhjen e informacionit, etj).
- Koha e përcaktuar më sipër zbatohet vetëm në pikën e tretë të rrjedhës (sekuenca për kriteret e ilustruara për referat të mirë).

Rrjedha:

- Çdo fëmijë zgjedh një temë (p.sh., «Hobi im», «Nga jeta e gjyshërve të mi», «Profesioni im i ëndërruar», etj), për të cilën ai/ajo do të donte ta mbajë me dëshirë një referat të vogël (vetëm; versioni: në çift). Referatet duhet të zgjatin 5–10 minuta.
- N fillojnë punën me planifikimin dhe mbledhjen e informacionit. Krahaso këtu materialin e përmendur M14 në broshurën «Dhënia e strategjive dhe teknikave mësimore në MGJP» (Për N të rinj duhet thjeshtëzuar).
- N i shënojnë problemet gjuhësore (fjalorin, etj) dhe për këtë përkrahen nga M.
- Në mënyrë plotësuese me këshillat në M14.7 për të ushtruarit gojor të referatit, në klasë do të zhvillohet një sekuencë e përbashkët për këtë. Kjo ndjek të njëjtën rrjedhë si më sipër tek nr. 22 dhe 29 (shembull i mirë/i keq, në bazë të cilave kriteret do të bëhet një referat i mirë; shikoni listën më poshtë). Në qoftë se tashmë mund të kthehemi përsëri te këshillat në të treguar tek nr. 22 dhe në të lexuar para të tjerëve, tek këshillat nga nr. 29, kjo natyrisht e thjeshtëzon punën.
- Eventualisht në një sekuencë të veçantë mund të përmbledhen mjetet shprehëse të të folurit dhe pjesë të fjalive për pjesë të veçanta të referatit; krahaso për këtë më poshtë nr. 31.
- N zgjedhin dy deri tri këshilla për referat, të cilave do tu kushtojnë vëmendje të veçantë. Ata e ushtrojnë referatin vetëm, në çifte ose në grupe të vogla dhe japin në mënyrë të ndërsjellë feedback (pyetje: «Çfarë është bërë mirë në këtë referat», «Çfarë mund të përmirësosh ende?»).
- Së fundmi, referati do të mbahet para tërë klasës ose grupit të nivelit; kjo pasohet nga një diskutim dhe vlerësim në aspekt të përmbajtjes dhe cilësisë së referatit. Për këtë të fundit, do t'i kushtohet vëmendje këshillave të referatit.

jo kështu (gabimisht)!

korrekt! (drejt)!



Këshilla për referat:

- Fol me zë të lartë dhe qartë, në mënyrë që të kuptojnë të gjithë!
- Mos fol shpejt, por as edhe shumë ngadalë. Bëj pauza.
- Mos e lexo tekstin, por fol në mënyrë të lirë dhe në bazë të skedave ku janë të shënuara shkurt çështjet kryesore.
- Trego, nëse është e mundur, një ose më shumë fotografi ose një objekt, i cili është i përshtatshëm për temën (vizualizimi).
- Përdore zërin tënd me qëllime të qarta; zë të lartë, të qetë; emocional, pyetës ...
- Përdore edhe mimikën dhe gjestet: ndryshoje të shprehurit e fytyrës dhe qëndrimin e trupit në mënyrë të përshtatshme me referatin.
- Vështroje publikun me sy në mënyrë të përsëritur.
- Përfshije publikun tënd, nëpërmjet asaj që ti gjatë referatit dhe në fund shtron pyetje ose kërkon mendimin e tyre.

Qëllimi

Propozimi mësimor i vërteton pikat e ngritura në nr. 30 nëpërmjet të një shembulli të thjeshtë. Këtu shkollohen aftësitë në gjetjen, përpunimin dhe prezantimin e informacionit; qëllimi gjuhësor qëndron në paraqitjen, zgjedhjen e fjalëve, shpejtësinë e të folurit, përdorimin e zërit, gjesteve dhe shprehjeve të fytyrës në mënyrë përkatëse si dhe të nxitet të dëgjuarit e interesuar.

kl. 4–6

45–60 min.



Materiali:
Objekte nga kultura e prejardhjes
(ose fotografi nga ajo).

Udhëzime:

- Ky ushtrim më së miri është që të ndahet në dy javë: në javën e parë të bëhet një hyrje në temë dhe në javën e dytë do të mbahen referatet. Gjetja e një objekti të mirë dhe përgatitja e referatit prej 5–10 min. pasojnë si detyrë shtëpie.
- Nëse janë në shfrytëzim kompjuterët, natyrisht mund të përdoren programet e prezantimit si PowerPoint ose Prezi.
- Është e kuptueshme që kompetencat e fituara tek ky ushtrim hyjnë në shërbim edhe për referate të tjera në MGJP dhe në mësimin e rregullt.

Rrjedha:

- M i informon N (klasën ose grupin e nivelit) për projektin, për mbajtjen e referateve të shkurtra për një objekt ose një personalitet nga kultura e prejardhjes (p.sh. një send i veshmbathjes, një specialitet ushqimor, një suvenir nga pushimet, një fotografi nga një ndërtesë, pikturë ose të një personaliteti...). Si model dhe hyrje M e mban vetë një referat të tillë të shkurtër (maksimum 5–10 min.) Është e përfytyrueshme që ai/ajo gjatë referimit në pjesë të caktuara të bie ndesh me disa rregulla dhe p.sh. flet me zë të qetë ose monoton.
- Në bazë të referatit të M, do të përpunohen këshillat për një referat të suksesshëm, ose nëse kjo tashmë është bërë, përsëriten. Krahajo për këtë hap më lart nr. 30, me një listë përkatëse të këshillave.
- Si ndihmë plotësuese M e përpunon bashkë me N se si është ndërtuar një referat i suksesshëm; këtu ai/ajo vë në dispozicion për pjesë të veçanta të referatit edhe mjete shprehëse, gjegjësisht pjesë të ndërtimit të fjalive në gjuhën e parë ose i përpunon këto me N:
 - Përhëndetja, hyrja dhe sqarimi i rrjedhës. Shembull: «Unë ju përshëndes ju me rastin e referatit tim mbi XY. Së pari do t'ju tregoj diçka për A, pastaj për B ...».
 - Tri deri katër pjesë të temës të prezantohen në mënyrë të ilustruar; në këtë rast deklarohen kalimet në to («Kaq për këtë pikë. Tash do të vijmë tek pjesa tjetër e temës, pra ...»).
 - Përfundimi, në të cilin bëhet edhe njëherë një kthim tek fillimi dhe/ose pikat kryesore edhe njëherë do të përmbledhen. Të jepet rasti për t'i sqaruar pyetjet. Të falënderohen dëgjuesit/et. («Unë u kam treguar juve për XY. Unë shpresoj që ju para së gjithash e keni kuptuar A keni edhe ndonjë pyetje? Shumë faleminderit për dëgjimin e vëmendshëm.»)
- Si përkrahje për mbamendje, N e marrin një fletë me këshillat më të rëndësishme (shih tek nr. 30) ose një kopje (eventualisht të thjeshtë) të materialit M14, nga broshura «Strategjitë dhe teknikat mësimore».

- Nëse mbetet ende kohë, N duhet të mendohen tashmë për objektin e tyre dhe ta skicojnë referatin në formë të një mind-maps (harte të mendimeve). Detyrë për javën tjetër: referati i shkurtër (5–10 min) të përgatitet dhe të ushtrohet.
- Në javën tjetër do të mbahen referatet dhe pastaj do të diskutohet në aspekt të përmbajtjes si dhe të kualitetit të gjuhës dhe respektimit të këshillave të referatit.

32

Për vlerësim: dritë blici

Qëllimi

N mësojnë të njohin një proces të thjeshtë të vlerësimit në të mësuar, i cili është i përshtatshëm për raste nga më të ndryshmet (pas një diskutimi, një recitimi, një referati etj.). Për ta përdorur këtë rrjedhë, duhet së pari që të kenë dëgjuar me vëmendje dhe të mësojnë që mendimet e tyre t'i përmbledhin në mënyrë të shkurtë e të përpiktë në më së shumti dy fjali.

kl. 1–9

5–10 min.



Udhëzim për literaturë:
Ernst & Ruthemann (2003),
f. 51 (shih në listën e literaturës).

Udhëzim:

- Rituali i blicit është i përshtatshëm për të përfunduar një përmbajtje mësimore ose një leksion. Për hir të shkurtësisë së tij e ka përparësinë që të gjithë N e marrin fjalën dhe e dëshmojnë të mësuarit e tyre. Blici gjithsesi nuk e zëvendëson diskutimin dhe evaluimin e të mësuarit të gjerë dhe me forma të orientuara në kritere; krahaso për këtë kapitullin 4c në hyrje.

Rrjedha:

- Secili/a N e përmbledh në përfundim të një leksioni, një referati, një diskutimi etj., në më së shumti dy fjali, se çfarë i pëlqeu veçanërisht (çfarë ai/ajo mendon se ishte veçanërisht mirë) dhe/ose ku ai/ajo sheh potencial për përmirësim. (Varësisht nga takimi që duhet evaluuar, pyetjet duhet të modifikohen.) Feedback duhet të jepet në formën e - unë, krahaso për këtë më lart nr. 13 «Të jepet feedback».
- M e përfundon raundin e blicit, nëpërmjet asaj që në njërin anë i jep 1-ose 2- evaluime fjalish dhe/ose ndihmesat e N i përmbledh shkurtimisht.

Vërejtje:

- Pjesët e ndërtimit të fjalive mund t'i ndihmojnë N që të përmbledhin mendimet e tyre. Shembuj: («Pikë kulminante e kësaj ... ishte për mua...», «Vështirësi më bëri mua ...». «Mua me pengoi, që ...»)

Variant:

- Dhurata fjalish: Secili N i bën një N tjetër të cilin e zgjedh, ose partnerit në të mësuar, 1 fjali-kompliment (p.sh. me rastin e ditëlindjes). Edhe kjo metodë duhet të ushtrohet. Komplimente të vërteta për shumë N nuk mund të gjenden dhe të pranohen aq thjesht.

Literatura e përdorur

- Autorenteam (2014): Sprachwelt Deutsch. Bern/Zürich: Schulverlag plus AG/Lehrmittelverlag Zürich.
- Bartnitzky, Horst (2011): Sprachunterricht heute. Berlin: Cornelsen Scriptor.
- Becker-Mrotzek, Michael (Hrsg.) (2012): Mündliche Kommunikation und Gesprächsdidaktik. Baltmannsweiler: Schneider Hohengehren.
- Brügge, Walburga; Katharina Mohs (2013): So lernen Kinder sprechen. München: Ernst Reinhardt.
- Büchel, Elsbeth; Dieter Isler (2006): Sprachfenster. Sprachbuch 2./3. Schuljahr. Zürich: Lehrmittelverlag Zürich.
- Büchel, Elsbeth et al. (2012, 2014): Sprachland. Sprachlehrmittel für die Mittelstufe. Arbeitstechniken (2012); Trainingsbuch (2014). Zürich: Lehrmittelverlag Zürich.
- Claussen, Claus (2013): Erzähl mal was! Materialien für das mündliche Erzählen in der Grundschule. Donauwörth: Auer.
- Ernst, Karl; Ursula Ruthemann (2003): 10 x 10 Gesprächsübungen. Kommunikationsaufgaben für die Grundschule. Zofingen: Erle-Verlag.
- Fischer, Gabriele et al. (2004): Spielerische Sprachförderung. Stuttgart: Ernst Klett.
- Hüsler, Silvia (2009): Kinderverse aus vielen Ländern. Freiburg i. B.: Lambertus (mit CD).
- Lindauer, Thomas; Werner Senn (2011): Die Sprachstarken 4–6. Zug: Klett und Balmer.
- Nodari, Claudio; Claudia Neugebauer (2011ff.): Pipapo 1–3. Bern/Zürich: Schulverlag plus AG/Lehrmittelverlag Zürich.
- Piel, Alexandra (2002): Sprache(n) lernen mit Methode. 170 Sprachspiele für den Deutsch- und Fremdsprachenunterricht. Mülheim an der Ruhr: Verlag an der Ruhr.
- Schader, Basil (2013): Sprachenvielfalt als Chance. 101 praktische Vorschläge. Zürich: Orell Füssli Verlag.
- Selimi, Naxhi (2010): Wortschatzarbeit konkret. Eine didaktische Ideenbörse für alle Schulstufen. Baltmannsweiler: Schneider Hohengehren.

Vërejtje, përvoja, ide të tjera:

Seria «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes (HSU)» përmbledh një radhë të vëllimeve, të cilat kontribuojnë në cilësinë e mësimin në gjuhën e prejardhjes si edhe në lidhjen e saj të mirë me mësimin e rregullt.

Adresantët e kësaj serie janë mësuesit e ardhshëm dhe ata që praktikojnë MGJP-në, si edhe institucionet që përgjigjen për ta në vendet e prejardhjes dhe të emigrimit.

Vëllimi i bazave (doracaku dhe libri i punës. Bazat dhe arsyet) transmetojnë ndër të tjera, pikat më të forta të pedagogjisë, didaktikës dhe metodikës aktuale në Evropën Perëndimore dhe Veriperëndimore.

Vëllimet me nxitje didaktike ofrojnë impulse konkrete dhe planifikime për sfera të ndryshme të mësimin (përkrahja e të shkruarit në gjuhën e parë etj) Të gjitha vëllimet lindën në bashkëpunim të ngushtë me mësues që praktikojnë MGJP-në, kështu që lidhja me praktikën dhe zbatueshmëria konkrete është bashkëmenduar që në krye.

Seria përfshin vëllimet e mëposhtme:



Seria «Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes» botohet në gjermanisht, anglisht, shqip, në gjuhën boshnjake, kroate, serbe, portugalisht dhe turqisht. Ajo do të publikohet nga Qendra IPE (International Projects in Education) e Shkollës së Lartë Pedagogjike të Cyrihut.